

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-2
K 98

Pëllumb Kulla

Shoku
Niqisfor

Komedi

8/4-2

K 98.

Pëllumb
Kulla

SHOKU
NIQIFOR

komedi

SHT^EPIA
BOT^WESE
«NAM^M
FRA^SHÉRI»



PERSONAZHET:

NIQIFORI — *drejtori i një uzine të përparuar*
ERIFILI — *e shoqja*
SHKËLQIMI — *i biri, mjek*
LENA — *e motra*
LEKSI — *djali i Lenës*
SHEFQETI — *shok i vjetër i Niqiforit*
TEFTA — *punonjëse në administratën e uzinës*
RUSHKA — *nëpunës i planit*
VALMIRA — *inxhiniere*
RADIOKRONISTI
DISA PUNËTORË TË UZINËS

Ngjarja zhvillohet në ditët tona.

TABLO E PARE

Apartamenti i Niqiforit.

SHKËLQIMI — Njeriu duhet të ketë po atë respekt, si për punën e tij, ashtu edhe për punën e tjetrit... Babai këtë nuk e ka hiç!

ERIFILI — Shsht... Leri llafet, t'u bëftë mamaja, se do të na ndizni sherrin... U kthyen nga Tiranë i lodhur dhe do t'i hipin ato të tijat.

SHKËLQIMI — Le t'i dëgjojë... Unë mendimin tim nuk e fsheh... Qëkur uzina e tij ka marrë flamurin, ndaj meje është bërë fare mos-përfillës. Për të unë si mjek nuk vlej asnje grosh. E rekomandoj për analizat, nuk vjen... I caktoj ilaçe, nuk i pi... Tensioni hedh valle...

ERIFILI — Shsht...

SHKËLQIMI — Bërtet vend e pa vend!

ERIFILI — Shsht...

ZËRI I NIQIFORIT — Zoti doktor, të njoftoj se po i dëgjoj të gjitha!

ERIFILI — E sheh? M'u derdh kafeja. (*Hyn në aneks*).

Nga dera shfaqet Niqifori me peshqir.

NIQIFORI — Hë, zbrazu. Ke më?

SHKËLQIMI — Mbarova.

NIQIFORI — Të lumtë... Se ti e di, po fillova unë...

Shkëlqimi del. Erifili i zgjat Niqiforit filxhanin e kafesë, të cilin ky e merr i kënaqur.

Kthehet Shkëlqimi me aparatin e tensionit në duar.)

SHKËLQIMI — Kafe pas darke nuk duhet të pish!

NIQIFORI — (*Pas një vështrimi të gjatë.*) Të kam thënë: këshilla pér kafenë, në mes të kafesë, nuk dua!

SHKËLQIMI — Kurse unë, baba, të kam thënë që kafe pas darke nuk duhet të kërkosh. Fajin e ka mamaja.

ERIFILI — E de, yt atë ka tri ditë në Tiranë...

SHKËLQIMI — (*Duke i lidhur Niqiforit llastikun e aparatit.*) Pse, atje nuk ka pirë thua ti? Rrezik edhe duhan, edhe raki.

NIQIFORI — Jo!

SHKËLQIMI — Ee, nuk të zë besë unë ty!

NIQIFORI — C'më çan kokën! Dëgjon, zoti doktor?!

SHKËLQIMI — Shsht! Mos bërtit! Bërtitjet japin impulse që sjellin dëme të pallogaritshme në enët e gjakut.

NIQIFORI — (*Me zë të ulët.*) C'më çan kokën! Doktorët si ti, plasin edhe derrin. «Mos pi duhan! Mos pi kafe! Mos pi raki!» E c'të pi? Aranxata?

SHKËLQIMI — Baba!

NIQIFORI — (*Duke imituar.*) «Duhani, kafeja, ra-

kia të shkurtojnë jetën. Doni të jetoni gjatë?
Kalluni flamën!»

SHKËLQIMI — Nuk i beson këto?

NIQIFORI — Ja, u kalla flamën... Dhe të jesh i sigurt se kështu, po aq do të rroj... Vec, pa to do të më duken ditët më të gjata, po!...

SHKËLQIMI — (Duke qeshur.) E ke gabim, baba.

NIQIFORI — Sa thotë tensioni?

SHKËLQIMI — Ç'të duhet, o baba, se mos pyet ti për të!

NIQIFORI — (E përmban veten.) Ja, se do të të lutem shumë, zoti doktor!...

ERIFILI — E, vazhdo tani, Niqifor, mjaft u zutë.

NIQIFORI — E ç'të them... Në konsultë uzinën tonë s'e hiqnin nga goja. Më thirrën edhe në «Ylli». Kishin një shkrim për uzinën tonë me rastin e marrjes së flamurit.

SHKËLQIMI — (Ndërsa shkruan.) Baba, mos jep shumë intervista, se mos mierresh më sy.

NIQIFORI — Pa rri urtë ti, mos të të rrëmbej drunë!

ERIFILI — Ua! Niqifor! Djali për nuse, ti i përmend drunë!

NIQIFORI — Po ç't'i them?! Për një drejtor uzinë, zoti doktor, marrja e flamurit të gara-ve nuk është një tregues i keq, bile është i mirë e po të më japësh leje do them se është shumë i mirë...

SHKËLQIMI — (Duke qeshur.) Nga ato tabletat, të të shënoj dy në ditë apo tri.

NIQIFORI — A, për doktor! Pyet të sëmurin!

SHKËLQIMI — E mira është që të të jap nga dy...

NIQIFORI — Nga dy më jep.

SHKËLQIMI — Por ama me konditë që ta zotërosh veten, të mos nxehesh e të mos bërtasësh, ndryshe... të takojnë tri!

NIQIFORI — Tri më vë. Tri! Dëgjon?!... Ta përmbyaj veten! Më lëshon mizat dhe më thua mos i përze.

ERIFILI — Po avash, more Fori! Niqifor!

NIQIFORI — Ja, moj, na u rrit djali dhe mu në sy më akuzon mua se gjoja më pëlqen të dukem!... Shëno tri aty. Shëno!... Mos ke ndonjë dyshim se ne e morëm flamurin pa hak?

SHKËLQIMI — Jo.

NIQIFORI — S'të shkojnë me mua ato, ëh! Si burrat!

SHKËLQIMI — Si burrat ta them: jo.

NIQIFORI — Po atëherë pse tek-tuk ma ngul nga një injekzion që më shpon sa s'thuhet?

SHKËLQIMI — Unë flas kështu në përgjithësi... Se ka raste, po shumë të rralla, që pas flamurit të zë një dremitje me ca èndrra...

NIQIFORI — Ne nuk shohim èndrra.

SHKËLQIMI — Nuk them për ju. Ka raste pastaj, që pas dremitjes, bie trumbeta e alarmit...

NIQIFORI — Ne s'kemi trumbetë... Le që ne nuk dremitim, ç'na duhet trumbeta!

SHKËLQIMI — Po nuk e them për ju, jo!... Grafiku i remontit prishet, ndonjë iniciativë e re lihet zvarrë...

NIQIFORI — Nuk lihet zvarrë. Pompat hidraulike ne do t'i... (*Me dyshim.*) Nga i di ti këto gjëra, zoti doktor!

SHKËLQIMI — Unë?

NIQIFORI — Kush t'i thotë?

SHKËLQIMI — Asnjeri.

NIQIFORI — Jo, se si shumë i informuar na je për punët tonë. Nga i merr vesh.

SHKËLQIMI — Ç'marr vesh unë?! ...Unë kam të sëmurët e mi. Kujdesem për ta, kujdesem edhe për tim atë...

NIQIFORI — I bukur kujdes! Posi! E de, dije: tensionin e kam nga ti.

SHKËLQIMI — Nga unë??

NIQIFORI — Po s'do mend! Se jot ëmë është e qetë... As ndihet e as më kundërshton... Afro tridhjetë vjet martuar, nuk kemi shkëmbyer asnjë llaf të ashpër. Kështu, Erifili? (I zbrasjet asaj.) Hë, moj, fol ti, ç'më rri si qyqe! Hape të shkretën, de! Të kam bërtitur ndonjëherë?

ERIFILI — Ama, pyetje dhe ti, Niqifor!

NIQIFORI — Thuaj, thuaj këtu: po apo jo?

ERIFILI — Jo!

NIQIFORI — Ti më ke bërtitur ndonjëherë mua?

ERIFILI — Unë ty?!? Jo, jo.

NIQIFORI — (Shkëlqimit.) Urdhëro, ja shën Niqifori, ja dhe shën Erifili!

SHKËLQIMI — (Mezi mban të qeshurën.) Të tëra fajet i kam unë.

ERIFILI — E mjaft tanë! Bëni një bisedë të qetë! Ti, Fori, na trego ndonjë gjë tjetër për Tiranën.

NIQIFORI — (Kategorik.) U dhashë fund!

P a u z ē

SHKËLQIMI — (*I shkon që pas dhe e puth.*) Baba, të lutem ndiqi këshillat e mia. Kam përshtypjen që nuk më dëgjon.

NIQIFORI — Po si nuk të dëgjoj, more qafir, mor qen bir qeni! Jam bërë për estradë, dëgjon? Atje në zyrë, një sirtar të tavolinës e kam lënë bosh fare... Kur më kërcejnë kacabujtë: faaaap! — e hap dhe lexoj këshillat e këtij birbos! I kam shkruar në një karton të madh: «Baba, mos bërtit! Tensioni ka tendencia rritjeje! Merr frymë, mbyll sirtarin dhe fol qetë!» Për nder, i kam shkruar.

SHKËLQIMI — Tallesh! I ke shkruar? Këshillat e mia?!

NIQIFORI — Të tuat i kam shkruar, se në kokë më duhet të mbaj ato të Çeços... «Fori, ruhu nga prepotenca! Edukimi në plan të parë. — Mos harro se të kemi dhënë një vërejtje për këtë të metë».

Bie zilja e portës

NIQIFORI — (*Bërtet.*) Hajde, Çeço, se të kërkua: (*Del të hapë portën:*)

ERIFILI — Të kishte ardhur më parë. (*Vë veshin për zhurmën në korridor.*) Qenka Leni me Leksin... Ububu!!... Tani Fori do të fillojë përsëri...

Në dhomë hyn Leni, një grua afër të pësëdhjetave, trupmadhe dhe e ngjallme. Leksi është një djalë i ri, truphollë dhe shtat-

lartë. Ai pëershëndet me kokë dhe ulet, pastaj sheh televizorin ndezur, ndërron vend dhe ulet në një pupë përpara ekranit.

LENA — Si u ngrysët? Fili, si je? Shkëlqim, t'u bëftë halla, q'bën?

ERIFILI — Hajde ulu, Leni!

LENA — Bah, Leksi ka turnin e tretë! U ktheva pak të shoh Forin. (*Niqiforit.*) Si dole nga Tirana?

NIQIFORI — Punë plot... Po ulu një çikë, moj motërzë!

LENA — (*Duke u ulur.*) Ja këtu në qoshe se nuk më mban vendi. Pardje Leksin ma dëboi brigadieri... nuk e pranoi në punë.

NIQIFORI — Pse?

LENA — Shkoi me vonesë. Të keqen, Niqifor, foli një çikë!

NIQIFORI — Po ç'të flas, moj motër... Kujt t'i flas?!

LENA — Brigadierit.

NIQIFORI — (*I befasuar.*) Ama... ti flas brigadierit?!

LENA — Po... se nuk bën figurë të mirë të dëbojë nga uzina tamam nipin e drejtorit të uzinës... Pa mendo se në ç'pozitë të ve ty brigadieri.

NIQIFORI — Demek brigadieri e ka fajin?

LENA — Po kush? Leksi është foshnjë.

ERIFILI — Aman, moj Leni, dhe ti!

LENA — Jo, jo... Unë jam revoltuar... jam revoltoar seriozisht... Ai brigadieri vetëm për hatër të Forit... Po nuk paskan respekt për Forin ata atje... Fori që është koka e uzi-

nës, që i nxori mu në ballë të karvanit...
Koka është kokë! Nuk është bisht...

NIQIFORI — Lena moj rehat me gjithë bisht e
kokë, se na çä...! Jo karvan e dëgër e mën-
gër! (Pauzë). E doktor... Hë, të lutem! Atje
kam sirtarin unë. E hap, lexoj. Këtu ç'të le-
xoj?! (Nxjerr recetiën.) Opo, na bëj tri tabletë
nga ato... U pa puna!

SHKËLQIMI — Ti, hallë, nuk e kuhton që ke faj
vetë se...

LENA — Ç'faj kam unë, more! Fajin e ka Niqifo-
ri, që nuk e bën të qartë një herë e mi-
rë se kush është Leksi. «Leksi është ni-
pi im dhe pikë! Kush prek atë, më ka pre-
kur mua!»... Niqifori është goxha drejtor!
Ka goxha hije!... Më thoshte njëri atje, se
vajta unë në uzinë, një që kishte një emër,
si të them, një emër zarzavatesh... fru-
tash... Se shoku Fiq... shoku Rrush...

NIQIFORI — Shoku Rushkë!

LENA — Hë, shoku Rushkë. Ai merrej me statis-
tikat atje... «Ka një vit e nëntë muaj e
gjysmë plot që shokut Niqifor nuk i është
kthyer asnjë urdhër!»... Mua — zemra mal!...
(Niqiforit.) Jep një urdhër edhe për Lek-
sin...

NIQIFORI — E di ç'ke ti, motë... pa shko tani e
përgatite djalin për turnin e tretë... Lere
Leksin këtu.

LENA — Ta përgatis?

NIQIFORI — E de, bëja gati ta marrë me vete...
çfarë i jep ti — bukë, gjalpë, sallam... apo
biberon se e ke foshnjë...

LENA — Ohu, Fori!... Të keqen motra... këtij foli
ti, po ama, edhe atje bëje punën tënde.
(*Duke dalë e përcjellë nga Niqifori.*) Posi...
Pastaj nuk na u hoq qafe ky turni i tretë...
Rrinë, rrinë dhe fuup!... Leksin! Turni i tretë!
Fëmijë i parritur akoma... cilimi... gjumi të
rrit, po kush?... (*Del dhe kthehet përsëri.*) Fori,
pa bisedo dhe një herë me këta që kini
përballë... Mbase i ndërrojmë apartamentet...
Të më kini pranë... Kush do të kujdeset për
mua?! (*Qaramane.*) Grua pa burrë... Me një
djalë akoma parritur. Lum si unë që kam
vëllanë drejtor... Ah, lere, mos e pyet!
(*Lena del. Ankesat e saj dalngadale shuhën.
Kthehet Niqifori.*)

NIQIFORI — Aleks!

LEKSI — Urdhëro!

NIQIFORI — Kthehu këtej! Shkëlqim, mbylle tele-
vizorin!

(*Shkëlqimi e mbyll*).

LEKSI — Urdhëro, dajë Fori.

NIQIFORI — Dajë?! C'të kam porositur?

LEKSI — Më fal, dajë — drejt... shoku dajë Fori...
Dajë shoku drejtor!

NIQIFORI — Si?

LEKSI — Shoku drejtor!

ERIFILI — Fori! Mos e tepro, de!

NIQIFORI — Rri, moj ti! E bukur nuk është, por
të mësohet! Nuk e din ti që edhe aty në mes
të kolektivit, «dojo» më thotë... O po s'ka,
s'ka dajo! Në shtëpi, në rrugë, në punë —

shoku drejtor të më thotë, dëgjon? (Leksit.)
Ke hyrë si ke hyrë atje tek unë... se më
parë na ke vjedhur kumbulla, zotrote!

LEKSI — (*I revoltuar.*) Nami po bëhet... Një herë
kam marrë kumbulla dhe! Isha i vogël...

NIQIFORI — Mbylle! Pse sa herë dashke ti të të
zënë me kumbulla!... Po nejse, ta falëm...
Tani puno mirë! Bëhu njeri e jo leckë topi!
Dua të të qërro... Dua të të transferoj gjékundi,
po si? Të pandrequr të të heq? Ndrequ!

LEKSI — Aha, as që kam për t'u ndrequr!... Unë
rrezik të shtrembërohem më keq. Nuk di
pse inxhinierja e remontit më ka inat... Ajo
më ndërsen edhe brigadierin.

NIQIFORI — (*Duke treguar me gisht Leksin.*) Pa
shiko, pa shiko, zonja dhëlpër... E tundi bish-
tin... E dëgjoni ju? M'i gjeti telat e fshe-
hur... Ky biçim, e di që unë kam aty një
inxhinierkë që nuk dua t'i shoh bojën dhe
hop na e vërvit historinë, sikur ajo i bie në
qafë nipit, se s'ka ç't'i bëjë dajos. I bie sa-
marit se s'ka ç't'i bëjë, si i thonë, s'ka ç't'i
bëjë...

LEKSI — (*Nxiton.*) ...Kalit!

NIQIFORI — Kalit?!... Hile dhe kjo, se i thonë
«gomarit»!... Po më thuaj, pse shkove vonë
pardje?

LEKSI — E di si qe...

NIQIFORI — Pa fjalë!... S'dua tërci-vërci unë! «Më
zuri gjumi. Nuk ra zilja!» Përse shkove vonë?

LEKSI — Dajë... shoku drejtor...

NIQIFORI — Qepe! Qepe se...

SHKËLQIMI — Baba, unë të shënova tri...

NIQIFORI — Katër më shëno! Tri janë për bërtitjet... Katér! Se do ta mbyt këtë sojsëz!... Këtë gjidi!... Prandaj e nisa time motër. E kam motër të vetme, pa njeri... dhe këtu më ze keq... Pa e dija unë... Po edhe unë pulë jam, nuk jam burrë... Prekem... «Ma hiq djalin nga ngarkim-shkarkimi». Ia hoqi zemërpula! Ia vura në remont. Po tani ç'do, mor bythë-lëvizuri i djallit, hë?! Prit, ku vete?

LEKSI — (*Me nënkuptim.*) Jam turni i tretë!

NIQIFORI — Ç'farë the?

LEKSI — Jam turni i tretë!

NIQIFORI — S'të pëlqen turni i tretë ty?! Sa një derr! Shokët e tu çajnë male... male, ore, male në turnin e tretë! Ti rrezik e ke mendjen te kumbullat.

LEKSI — Ufff!

NIQIFORI — Ore, do të të futem mirë me ata të rinisë! Turni i tretë! Nipi i drejtorit, nipi i dajos! Po dajua yt ka punuar njëzet vjet turni i tretë! Njëzet vjet kam ngrënë hekur me dhëmbë!

SHKËLQIMI — Baba!

NIQIFORI — (*Leksit.*) Mos lëviz! E di pse të mbajta?

LEKSI — E di! (*Përmendësh.*) Të më qortosh që të vij në rrugë të drejtë. Të më qortosh që t'i vë gishtin kokës, që të bëhem i denjë për shoqërinë.

NIQIFORI — Të të qortoj? Jo, or, jo! Që të të rrash! Sonte do të të futem vënçë! Shkëlqim, kushtëri e ke. Rrihe ti! Unë do të shkoj të laj sytë, se më hipi zjarri. (*Duke dalë.*) E dua peshk!

ERIFILI — Po dhe ti...

NIQIFORI — Lermë, grua, kështu di unë! (Del).

LEKSI — Hajde, Çimi!... Fillo! Më rrih! Se më vajti vonë pér punë.

SHKËLQIMI — Pse sillesh kështu ti, Leksi?

LEKSI — Sepse kam cipë.

SHKËLQIMI — Ke cipë?

LEKSI — Cipë, cipë... Të ishte ndonjë tjetër, hë...

Nuk më rregullon dot një vend më të mirë...

Po si!... E ka në dorë... Një jam unë!... Një nip i vetëm, djalë i vetëm. i motrës së vetme!... Një punë pa lodhje, pa turne,... ku dita të jetë ditë e nata-natë...

SHKËLQIMI — Pa shiko!... E di ti që atje në uzinë ke punë me rëndësi?

LEKSI — Unë punë me rëndësi?! Në remont... Phë!

SHKËLQIMI — U shpreha gabim. De-ty-rë me rëndësi! Ti mund ta ndihmosh babanë... Ta nderosh dajon tënd... Po ti kështu i nxin faqen.

LEKSI — Po ai, pse nuk më nderon mua?

SHKËLQIMI — Ai të nderon, punon mirë.

LEKSI — Mua, ore, mua... Ja, të më japë një karro elekrike... Dhe të punoj dhe të bëj varavingo me të... Ashtu më nderon...

SHKËLQIMI — Xhano! Ti qenke goxha front pune dhe unë nuk e ditkam. Ik, pa do të bise-dojmë.

LEKSI — Më të shkel unë këtu, bah!

SHKËLQIMI — Do të vij edhe tek ti!

ERIFILI — Leksi, e ke gabim, xhani i tetos... Shko, po e ke gabim.

LEKSI — Ti, teto, në vend që të më ndihmosh...

Dhe ti e kupton, se ti je tetua më e mirë që ka bota... Thuaji dajos, hë thuaj... Është ajo karroja elektrike... Ajo jeshilja!...

ERIFILI — Leksi, xhan!

LEKSI — Jo xhan me llafe, teto... Kështu nuk besoj unë... Më rregullon dot atë jeshilen... Bëfsh gjumë të ëmbël, kushëri. Natën e mirë! Unë po iki në turn, ti bëj nani! (Del.)
ERIFILI — Phë!... E shikon ç'hall të ze... Do t'i them një fjalë Forit.

SHKËLQIMI — Ju e dëmtoni atë... Rrugën e drejtë të gjithë e dini, po ecni, ecni dhe lodheni.

Hyn Niqifori

NIQIFORI — E rrahe?

SHKËLQIMI — Posi.

NIQIFORI — Ju fute mirë?

SHKËLQIMI — Peshk, siç më the ti.

NIQIFORI — E ku e ke?

SHKËLQIMI — Më kërcyen edhe mua... Nuk durova dot dhe e hodha nga dritarja.

Niqifori e sheh të birin me qortim. Bie zilja. Erifili shkon ta hapë.

ZËRI I SHEFQETIT — Erdhi?


ZËRI I ERIFILIT — Ja, para një ore... Nuk t'u durua, Çeço?

Hyn Shefqeti, një burrë me një pamje prej babaxhani. Ka një temperament të qetë, krejt ndryshe nga Niqifori.

NIQIFORI — (Duke u takuar.) Hajde, Çeço, hajde!

SHEFQETI — E zgjate.

NIQIFORI — Lere... Ulu e na llofos tanë. Nga shtëpia si i ke, si venë punët në uzinë, hë!



SHEFQETI — Në uzinë punët venë për bukuri, nga shtëpia fare mirë... Unë nesër marr lejen e zakonshme.

NIQIFORI — Lejen e zakonshme?!

SHEFQETI — E po. Sot pasdite tornoja ime dhe e Hitos u futën në remont...

NIQIFORI — U futën në remont?!

SHEFQETI — Sipas grafikut.

NIQIFORT — C'grafik, more Çego!... Para se të ikja në Tiranë, inxhinieren e urdhërova ta shtyjë... Pa shiko!

SHEFQETI — E po, si duket, nuk e gjeti atë mundësi. Pastaj ua kishe shtyrë një herë.

NIQIFORI — Po kam hallin e tremujorit!

SHEFQETI — Dhe ajo ka hallin e makinerive.

NIQIFORI — Mua nuk më dhimbsem makineritë, mua! Vetëm inxhinerikës! Po është tjetër gjë... Është grerëzë... Po grerëzave unë u rrëfej vendin...

SHEFQETI — Thuaj më mirë bletë, të ketë lezet...

NIQIFORI — Qoftë dhe bletë... Bën mjaltë, po s'i durohet bërbëri...

ERIFILI — Kush është kjo, more Niqifor?

NIQIFORI — Është një inxhiniere që na u bë pesh-qeshi... Një hundështypur... Një rëgel i thartuar... Një femër nursëze me huqe prej mushke që vëç kur e nis ndonjë muaj për eksperience, jam i qetë... Po muaji është muaj! Tridhjetë e një ditë ka. Mallkuar qoftë ai që s'e bëri me njëqind e tridhjetë e një. Do ta anuloj remontin që tanë... (*Kthehet nga dritarja*) Meqë ra fjalë, Çego... Nga ca të dhëna, këtë një vit e nëntë muaj e

gjysmë plot që nuk më është thyer asnje urdhër... E dija që kjo xanxare do të ma thyente e para.

Niqifori del. Dëgjohet kërkellitja e telefonit.

ZËRI I NIQIFORIT — Alo... Kush, je? Drejtori? Po drejtori jam unë, more karagjoz... Më bëki dhe shakara. Më thërrisni ndonjë nga ata të remontit... A është inxhinierja aty?!... Aq më mirë!...

ERIFILI — E zeza unë! Nuk e dashka hiç atë inxhinieren!

SHEFQETI — Nuk e do se nuk i vjen shumë pas telave... Ja, bëmë tani modelin e një pompe të importit... Goxha punë, eh... Fori sa s'luajti mendsh nga gëzimi, po nuk para ia ka qejfi që t'i futë në linjë që këtë vit... Inxhinierja shkroi një artikull e këmbëngulte që të futen... Kuptoni tani si janë ndezur me njëri-tjetrin?

SHKËLQIMI — (Që s'ka folur deri tani.) Xhaxha Çego,... dhe me ty unë nuk pajtohem...

SHEFQETI — Përse?

SHKËLQIMI — Pavarësisht që babanë e ke shok të ngushtë, shok fëmijërie. E di. Ti je sekretar i organizatës bazë... Duhet të mbash qëndrim të rreptë.

SHEFQETI — Kur gabon, natyrisht, unë nuk pajtohem me të.

SHKËLQIMI — Mospajtimi duhet treguar.

SHEFQETI — Ti doktor i zemrës je, por zemrat nuk i njeh dot pa i çarë. Yt atë është ca i pagdhendur në shprehje, ti e di... Unë i flas...

Ja, si thua ti, meqë foli ashtu, të ngrihesha
e të ikja në shenjë mospajtimi' me të?

SHKËLQIMI — Për mendimin tim, po.

SHEFQETI — Avash, o Çimi, avash.

SHKËLQIMI — Ato shprehje për inxhiniere Val-
mirën...

SHEFQETI — Për kë?

SHKËLQIMI — Për inxhiniere Valmirën.

SHEFQETI — E ditke mirë ti që e quajnë Val-
mira...

SHKËLQIMI — E di. E quajti hundështypur... re-
çel të thartuar... me huqe prej mushke...
Këto i aproponi ju?

SHEFQETI — Jo, si i aprovokam!

SHKËLQIMI — E quajti nursëze. Kulmi! Përshty-
pje krejt e gabuar!... Për mua, për mua ajo
buzëqesh shpesh...

SHEFQETI — Po si more, shpesh...

SHKËLQIMI — Ka një buzëqeshje të shpeshtë dhe
gjithë nur...

SHEFQETI — Jam i téri me ty.

SHKËLQIMI — Buzëqeshja e saj të magjeps... dua
të them që ftyra e saj nuk nxin, po ndrin
nga gazi... Pra të gjitha sa u thanë nuk
janë të vërteta...

SHEFQETI — Aspak...

SHKËLQIMI — Pra, janë shpifje!... Atëherë ju du-
het ta thoni fort fjalën tuaj kur shpifet për
kuadrot...

SHEFQETI — Avash, avash... Po ti pse revoltohesh
kështu.

SHKËLQIMI — Sepse e dua.

SHEFQETI — Kë dashke ti, mor?

SHKËLQIMI — Kë dua?! Babanë tim dua! Për atë po flasim.

ZËRI I NIQIFORIT — Inxhiniere Valmira? Dëgjo, inxhiniere... Dëgjo inxhiniere... U shty një herë, s'u shty një herë... Moj shoqe, grafikun e di unë!... Pra do të filloni remontin ditën e parë të tremujorit të dytë!... Kaq... Nesër ora shtatë zero zero tornot i dua në punë... pikë!

Dëgjohet përplasja e fortë e telefonit. Ni-qifori kthehet në dhomë.

SHEFQETI — T'i kishe thënë dhe natën e mirë, Fori!

NIQIFORI — Urdhëro?

SHEFQETI — Asaj çupës t'i uroje natën e mirë!
Nejse... Pa na thuaj, bisedove në ministri për linjën e pompave? C'thanë ata shokët?

NIQIFORI — Asgjë...

SHEFQETI — Si asgjë... Nuk u pëlqeu kjo?

NIQIFORI — Jo... dmth. u pëlqeu... C't'u pëlqente, unë nuk e hapa fare atë muhabet... Dëgjo, Çeço, për këtë vit ato janë telashe... S'na duhen tre qe, mjافت i kemi dy!

SHEFQETI — (Befas.) E po, Shkëlqim, tani mendoj unë është tamam rasti për t'u ngritur e përtë ikur... (Ngrihet e merr kasketën.) Mirëmbetshi!

ERIFILI — Çeço, unë as të gostita!

SHEFQETI — Një herë tjetër, Erifili.

NIQIFORI — Po dale, Çeço! Nuk i thamë të gjitha.

SHEFQETI — Bisedojmë nesër. Natën e mirë!

Shefqeti del i shoqëruar nga Erifili.

NIQIFORI — E dija që do të nxehet. E dija... (Ngrihet.)

ERIFILI — (Që kthehet.) Niqifor, je i lodhur... Bjer
në shtrat. Ku po shkon?

NIQIFORI — E di që do të vërtitem nëpër çarçafë
sa të vijë mëngjesi. ...Nuk mbyllen kollaj
ato tornot. Se shkoi e i hapi ajo gjinkalla.
Po vete në uzinë të shoh mos kanë ndonjë
hall e pastaj vij e fle rehat.

Erifili i bën shenjë Shkëlqimit që ta ndalë.
SHKËLQIMI — Je njeri i çuditshëm, baba! Kam
qejf të të ngjaj.

NIQIFORI — (Duke u veshur.) Ç'më çan kokën...
T'i harroj unë ato që më the?!

SHKËLQIMI — E megjithatë kam qejf të të ngjaj.

NIQIFORI — E megjithatë ç'më çan kokën! (Del.)

ERIFILI — (Duke ngritur filxhanët.) E zeza unë!...
Të dëgjon, Çimi, të dëgjon.

SHKËLQIMI — Kush?

ERIFILI — Yt atë... Duket sikur nuk ta vë veshin,
por ja!... (Tregon filxhanin.) Ti i hoqi vërejtjen,
ai e ka lënë kafenë në mes.

SHKËLQIMI — Njeri i ngatërruar, mama.

P a u z ē.

ERIFILI — Të pashë me një shoqe sot.

SHKËLQIMI — Ah, po, një kolegia ime, mjeke.

ERIFILI — Ajo është?

SHKËLQIMI — Cila?

ERIFILI — E kam fjalën... se dua të them... më
pëlqeu shumë!

SHKËLQIMI — Aa... Është e martuar.

ERIFILI — Ah, të shkretën! Të mirat nuk i lenë
të bien përdhe... E kanë mendjen në vend
bota... Kërkojnë, gjejnë, martohen, kurse ti!...

SHKËLQIMI — (*Pas një pauze.*) E kam gjetur dhe unë, mama.

ERIFILI — Nuk të besoj unë ty.

SHKËLQIMI — Të betohem, mama!

ERIFILI — (*E gëzuar.*). Uuu... (*Bërtet.*). Niqifor!

SHKËLQIMI — (*I ze gojën.*). Shshsht... Po i the babait, nuk kemi gjë... Këtë sekret e kemi ne të dy.

ERIFILI — (*Me zë të ulët.*) Mirë. Si është? Pse të pëlqeu? Është e bukur?

SHKËLQIMI — Çka.

ERIFILI — Si «çka»?! Ç'do të thotë kjo?!... Më fol.

SHKËLQIMI — Është... si të them, është hundë-shtypur.

ERIFILI — Iiii!

SHKËLQIMI — Bionde, po pa lezet.

ERIFILI — Eëë!

SHKËLQIMI — Si të them... Ke ngrënë ndonjëherë reçel të thartuar?

ERIFILI — Ooo!... Po të paktën si sjellje...

SHKËLQIMI — Nursëze!... Ka huqet si të mushkës.

ERIFILI — E zeza unë! Ti s'je në vete! E pse kërkon ta marrësh ti?

SHKËLQIMI — Po kush ta marrë!

ERIFILI — Le ta marrë ndonjë tjeter?

SHKËLQIMI — Po ai tjetri nuk është gjynah? Më mirë e marr unë, bëj një të mirë.

ERIFILI — Unë nuk të lë... Do t'i them Niqiforit ta shohë... Po e pëlqeu ai...

SHKËLQIMI — Ai nuk e pëlqen kurrsesi!

ERIFILI — Ku e di ti?

SHKËLQIMI — E ka në uzinë... Inxhiniere...

ERIFILI — Mos është ajo që?...

SHKËLQIMI — Ajo... U bënë dy vjet që njihemi.

ERIFILI — Po kjo bela!... Pastaj ti thua që ajo s'është... Apo tallesh me fjalët e tyt eti?...

Pse qesh? Është e bukur apo...

SHKËLQIMI — Nuk e di. Po ama sidqoftë dy rrugë ka: o martohem unë me të...

ERIFILI — Hë!...

SHKËLQIMI — ...O ndryshe do të martohet ajo me mua!

Fundi i tablosë së parë

TABLO E DYTE

Zyra e Niqiforit. Mëngjes. Tefta flet në telefon.

TEFTA — Këtu zyra e shokut Niqifor... Ai më ngarkoi t'ju them se pasqyrat e plota do t'jua dërgojmë nesër..., Ju lutem,

Tefta lë telefonin. Hyn Rushka.

RUSHKA — Akoma, moj Tefta?

TEFTA — Akoma... ndodhet nëpër reparte.

RUSHKA — Për nder, ky njeri po na bën edhe ne të na rëndet zyra

TEFTA — *(Duke punuar.)* Ia solle shokut Niqifor ato që kërkonte?

RUSHKA — Ja ku i kam... Ai mbrëmë m'u shkreh kot.

TEFTA — Ama, ti u trembe.

RUSHKA — Unë? Jo.

TEFTA — U trembe që ç'ke me të... Dhe e kyçë gojën.

RUSHKA — E kyça, motër Tefta, se... e di, gjith-

çka varet nga interpretimi... Interpretimet janë ato qerrata gjyslyke që mirësjelljen e shohin si servilizëm, fjalën e mirë si lajkë... Ti ke respekt pér drejtorin... Po gjyslykët respektin e shohin si frikë.

TEFTA — Ah, dallohen ato të shkreta, Rushkë, dallohen... Ja, unë, të pashë të dridheshe para shokut Niqifor... A thua të dridhet njeriu dhe nga respekti?...

RUSHKA — Jo, motër, s'është momenti pér t'u trembur... Në ndërmarrjen e përparuar nuk bëhen lëvizje.

P a u z ë.

TEFTA — (Konfidenciale.) Ç'kemi ndonjë të re nga Valmira?

RUSHKA — Mallkuar qoftë dita që të hapa zemrën! Ta hapa si shoqe e vjetër e zyrës, të më ndihmoje... Të fshehtën ma more dhe ndihmë s'më dhe...

TEFTA — Pa ndihmë, pa ndihmë!... Njerëzit sot martohen vetë... Po kam frikë se nuk do të pranojë.

RUSHKA — Përse jo?! Qëllimet e mia — të palëkundshme!... Konditat e mia — jashtë-zakonisht komode: shkollë të lartë, punë të mirë... Stabël!... Rrjedh nga një familje zanatçinjsh të ndershëm... Babai rrëbaqepës... Nëna shtëpiake... Shtëpinë e kemi tonë. Gjer me verandë... Me kopsht... Imagjino. eh, sikur ajo të martohet me mua punën do ta kishte ...dy minuta larg!...

TEFTA — Ruhu, Rushkë, ruhu.

RUSHKA — Nga kush?

TEFTA — Ja, nga ndonjë që e ka shtëpinë më afër... Në dashuri largësia shtëpi-punë është vendimtare!... Po pse nuk ia shfaq?

RUSHKA — Unë ia kam shfaqur.

TEFTA — Kur? Si? Qysh? Me letër?

RUSHKA — Gojarisht.

TEFTA — I propozove direkt?

RUSHKA — Phë! Në fund të fundit ne s'jemi dosido, por njerëz me kulturë... Dhe për ne ka plot mënyra të tërthorta bisedimi, që dëshmojnë për ndjenjë dhe për intelekt e që një i tretë nuk e kupton dot ku rrëh çekani...

TEFTA — Pa hë, të lutem!

RUSHKA — Në prag të Vitiit të Ri, të kujtohet, unë e Valmira bënëm pjesë të dy në komisionin për lodrat e fëmijëve të punonjësve tanë... Kur na caktuan, unë i thashë: «Ne të dy na caktojnë kot. Sikur të kishim fëmijët tanë dhe ne!» Me një fjalë, kuptoje ti tani!

TEFTA — E kuptoi?

RUSHKA — Menjëherë: «Vërtet, tha, të kishim fëmijët tanë edhe ne do të qe më mirë». Hë, si thua? Pak është kjo?

TEFTA — Po pse nuk thua që...

RUSHKA — Prit... Rrugës për në dyqan kishte dy mendime... Të merrnim për fëmijët kobure me ujë apo arinj... Unë isha për arinjtë... Valmira u bashkua me mua... Fituan ne — arinjtë!... Ajo gjithnjë bashkohet me mëndimet e propozimet e mia!

TEFTA — Po këto nuk janë prova.

RUSHKA — Të jap unë prova më të fortë... Një

ditë unë shpreha mendimin se fejesat e shpejta janë të papjekura, se vajzat që pranojnë menjëherë janë mendjelehta, shkurt se fitoret që arrihen lehtë s'duhet të quhen fitore... Dhe e ftova në një takim.

TEFTA — Ia bëre ftesën hapur?

RUSHKA — Jo, jo... Tërthor si gjithmonë... Ishte e shtunë... «Të dielave, — thashë, — unë e kam zakon të shetis në parkun buzë lumi... Të nesërmen dola në park... E merr dot me mend?

TEFTA — Erdhi?

RUSHKA — Nuk erdhi hiç! Tamam siç dëshiroja unë... Hiç, fare! Shenjat janë të qarta.

TEFTA — Po nuk ia the copë...

RUSHKA — Më vonë...

TEFTA — E pse më vonë?

RUSHKA — (*Konfidencial*.) S'është kohë e përshtatshme... Nuk shihet me sy të mirë... Drejtori nuk e do. Të deklarosh dashurinë për Valmirën është njësoj si t'i thuash drejtorit. «S'pyes për ty!...» Ndërsa unë përtë kam respekt.

TEFTA — Si i thoshin respektit me ato gjyslyket?

RUSHKA — Frikë, po kjo nuk ka lidhje fare... Unë kam respekt të pastër... Kurse ajo, ncë, ncë, ncë... Ajo nuk mendon fare për vete... Një, dy dhe konflikton me drejtorin për punë të remontit. Prite kur të kërcasë sherri edhe sot.

TEFTA — E po, detyra është detyrë!

RUSHKA — E drejtori është drejtor.

TEFTA — Rushkë, mor i zi, ti do më shumë Niqiforin se Valmirën!

RUSHKA — Urdhéro?

Dera hapet me vrull. Hyn Niqifori.

NIQIFORI — Tefta, dua inxhiniere Valmirën! Urgjent!

Tefta del me ngadalë. E shpejton vetëm fjala e fundit e Niqiforit.

NIQLFORI — (Rushkës.) Ti i solle pasqyrat?

RUSHKA — Me hollësirat më të vogla.

Niqifori merr pasqyrat dhe i shikon me vëmendje. Rushka ndjek përshtypjet e Niqiforit.

NIQIFORI — Më pëlqen, Rushkë, më pëlqen... Me këto nënvizime... Me theksimet me ngjyra të ndryshme... Pasqyrat e tua flasin, Rushkë, kanë gojë... Eh?

RUSHKA — T'ju them të drejtën, shoku Niqifor, nga fjalët e mira mua më bien djersë...

NIQIFORI — Djersi, Rushkë, djersi!... Hm!... Pa të shohim kryesoren... Tani shifrat... Këtu më dalin djersët mua... (Nis t'i shohë një nga një). Keq!

RUSHKA — Shumë keq!

NIQIFORI — Këtu, mirë.

RUSHKA — Mirë këtu... Shumë mirë!

NIQIFORI — Kjo, çka.

RUSHKA — Çka.

NIQIFORI — Bile jo dhe aq keq.

RUSHKA — Shumë mirë!

NIQIFORI — Këtu jemi keq!

RUSHKA — S'ka ku të vejë më keq!

NIQIFORI — (Ngre sytë te kalendari.) Vjet si ishim në këtë periudhë?

RUSHKA — (I pavendosur.) Çka...

NIQIFORI — Ishim më mirë, apo jo?

RUSHKA — Shumë më mirë...

NIQIFORI — Po e bëre shurrën në det, kripa ta sjell më gjellë... E bëmë, na e solli...

RUSHKA — Figurë e bukur, popullore, hë!

NIQIFORI — Ato ditë që morëm flamurin sikur brohoritëm ca e na u ngjir zëri... Por si një e një dy, duhet të dalim dhe këtë vit. Siç dolëm vjet: njëqind e shtatë për qind!

RUSHKA — Që të na thonë pastaj mbetën në vend numëro! Jo, shoku Fori, por duhet synuar te njëqindetëshi... Se është në logjikën e të gjithëve që i kanë sytë mbi ne... Ja, fjalë vjen, do të... dalim njëqind e gjashtë.

NIQIFORI — Prapë është goxha mirë!

RUSHKA — Po, por do të thonë: «Ranë! Se s'kanë ata! Diçka nuk shkon!»

NIQIFORI — Të hëngshim dasmën, Rushkë! Ja, për këtë sedër më pëlqen, kurse ajo, (*brof në këmbë*) kurse ajo nuk pyet për këto. As për shifra, as për sedër, as për plan. Ka kokën e saj...

Hyn Tefta.

TEFTA — E gjeta inxhinieren... po vjen.

Hyn plot gjallëri Valmira. Është një vajzë e shkathët, me lëvizje të prera e të vendosura.

VALMIRA — (*E çiltër, gazmore.*) Mirëmëngjes, shoku Niqifor... Më thanë që kishit qenë në repartin tim... Unë ndodhesha në magazinë... (*Rushkës.*) O Rushkë!... Mirëmëngjes, Rushkë! Si duke shët sot se nuk jemi parë fare...

(Pauzë.) Shoku Fori, dy torno i filluam ne...
Tani.

NIQIFORI — Moj vajzë!... Përsëri po përplasemi
për ato dy tornot...

VALMIRA — Sot janë katër... Do të hapim edhe
dy të tjera se erdhi dita dhe për to...

NIQIFORI — Ashtu. Pse ndeshëmi gjithnjë bashkë
ne? Dhe gjithnjë te remonti.

VALMIRA — Po unë... në remont punoj.

NIQIFORI — Çfarë kam thënë unë?

VALMIRA — Pasi më keni shtyrë datat disa herë,
më në fund thatë se ditën e parë të tremu-
jorit të dytë...

NIQIFORI — (E ndërpret.) Mirë, mirë... Dje të dërgo-
gova fjalë që do të ketë një shtyrje të re.

VALMIRA — Po unë nuk jam dakord...

NIQIFORI — Ah, ja! M'u prish gjiza mua nëse je
apo nuk je ti dakord.

VALMIRA — Gjiza?! Më fal, ç'hyn gjiza këtu, drejt-
tor? Më duket se fjalë të tilla...

NIQIFORI — U tha tani, iku... Ti cipëhollë, nuk
duron fjalë për gjizën, sikur të kemi të
baxhos... Të kemi inxhiniere në uzinë e
uzina ka detyra, ka plan... e përpara planit,
ngule mirë në kokë, unë nuk përfill asgjë...
Asgjë!

VALMIRA — Po nuk kemi ndonjë shtesë plani me
sa di unë. (Pauzë.) Pyes seriozisht. Të pak-
tën m'u përgjigjni ju, shoku Rushkë.

NIQIFORI — Plani është ai që kemi miratuar.

VALMIRA — Atëherë dhe grafiku i remontit është
ai që kemi miratuar në këshillin teknik. E
kini firmosur dhe ju. E unë jam ngarkuar
ta zbatoj.

NIQIFORI — Ti ta zbatosh e të lumshin duart,
po ja, ne nuk jemi plotësish me ritmet që
duhet të ishim si pararojë.

VALMIRA — Për këtë unë nuk kam faj.

NIQIFORI — (*Mezi përbahet.*) E kam fajin unë.
Po unë kam mundësi, të urdhëroj. E sot ur-
dhëroj — të shtyhet! (*Rushkës.*) Vazhdoj-
më ne.

Valmira ka mbetur në një anë dhe duket e lëkundur.

RUSHKA — (*Vazhdon tregimin e pasqyrave.*) Këto
këtu...

VALMIRA — Këtë herë urdhërin e kundërshtoj.

NIQIFORI — Çfarë?

VALMIRA — Urdhërin e kundërshtoj!
Pauzë e rëndë.

NIQIFORI — (*Mundohet të ruajë qetësinë e zërit.*)
Po bëhen afro dy vjet që në uzinë mua nuk
më kanë kundërshtuar asnjë urdhër. Ç'tre-
gon kjo?

VALMIRA — Kjo... tregon se në këto dy vjet ke-
ni dhënë urdhëra shumë të drejtë.

NIQIFORI — (*I habitur për gjakftohtësinë e vaj-
zës.*) Dhe ky që po jap sot nuk është i
drejtë?

VALMIRA — Jo, shoku drejtor... Kam respekt, por
nuk është i drejtë!

NIQIFORI — (*Pa u përbajtur.*) Atë e di unë! Dë-
gjon. Atë e di unë!

VALMIRA — (*E qetë.*) Tani edhe fjalët tingëllojnë
rëndë, po s'kemi ç'të bëjmë. Atë, në radhë
të parë, e di unë... Shtyrja e remontit ndih-
mon planin mujor apo tremujor, por plani

vjetor s'ka ndonjë dobi se remonti do të bëhet se do të bëhet... Por shtyrrja e tij dëmtion makinerinë që është e çmueshme.

NIQIFORI — Se nuk e di unë! Hajde të të tregoj arat!

VALMIRA — ...Dhe në këto kushte që jemi është edhe më e çmueshme.

NIQIFORI — Hajde, baba...

VALMIRA — Veç kësaj, makineria po nuk u remontua, humbet preçizionin dhe nxjerr cilësi të dobët.

NIQIFORI — Hajde, baba... E ç'jam unë fëmijë, që m'i mëson këto! Hë! Ç'jam unë!

VALMIRA — Unë dua që ta dini se ç'jam unë... Jam pëgjegjëse e remontit.

NIQIFORI — Ti je hiç, dëgjon? Je një hiç!... Nul, si i thonë evropiançe! Je një fyckë, hundë-përpjetë, që kërkon të luash mendsh drejtoren tënd.

VALMIRA — Këto... Këto... Unë kam respekt për ju, por...

NIQIFORI — Pallavra! Dokrra me qumësht!... Ti s'ke pasur, s'ke e s'ke për të pasur kurrë respekt për mua! Shko tani e mbylli prapë. Kjo është fjala e fundit. (*Rushkës.*) Vazhdojmë!

RUSHKA — Këto këtu...

VALMIRA — Nuk më detyroni dot!

Përsëri pauzë.

RUSHKA — Valmira! Shoqe Valmira!

VALMIRA — Sot do ta shpie mendimin tim deri në fund. Do të kërkoj ndihmën e kryeinshih-

nierit dhe, po qe nevoja, do t'i drejtohem byrosë së organizatës.

NIQIFORI — S'më ka vënë njeri në këto pozita! Më ve një rabeckë që s'i kanë dalë akoma pendët! Po të le vetëm dy minuta të qetësohesh dhe të mbledhësh mendjen! (*Del duke përplasur derën.*)

TEFTA — Vali, budallaqe, mblidhe veten... Të lumtë! Hajde se nuk e lë njeri atë të marrë nëpër këmbë... Ja, kështu. (*Del me nxitim pas Niqiforit.*)

RUSHKA — (*I afrohet vajzës.*) Valmira... Valmir-kë... Qetësuhu...

VALMIRA — Ah, Rushkë, Rushkë!

RUSHKA — Urdhëro!

VALMIRA — Më beso, po vuaj.

RUSHKA — Të besoj o... të besoj o... shpi... inxhinierë e remontit.

VALMIRA — Sa situatë e ngatërruar!

RUSHKA — Shumë!

VALMIRA — Rushkë i dashur, ti nuk e kupton dot tërësish këtë.

RUSHKA — I kuptoj të gjitha.

VALMIRA — Në këtë mes ma lidh gjuhën dashuria për... për...

RUSHKA — Për?...

VALMIRA — Për...

RUSHKA — Mos e vazhdo se nuk kam fuqi ta dëgjoj... Dhe kjo më jep zemër. Dije, pra, se thellë-thellë unë jam kundër shokut Niqifor... Ti sot u tregove burrëreshë.

(*Zilja e telefonit. Një tingull i vëtmuar.*)

RUSHKA — Por u nxitove... (*Zilja.*) E teprove

(Zilja.) Shkurt, bëre gabim.

VALMIRA — Faleminderit, Rushkë!... Faleminderit! (Del rrëmbimthi.)

RUSHKA — Obobo!... Çdo gjë më duket si èndërr.
Fjalët e saj... Prekja e saj... Ja, këtu... (Zilja.)
Alo?

Kthehet Niqifori.

RUSHKA — Èshtë djali juaj, Shkëlqimi.

NIQIFORI — (Merr telefonin.) Po... A e di unë sa e kam tensionin? Aq sa ç'na duhet. Dyqind e njëzet volt! (Mbyll telefonin.) Si thua, Rushkë, nuk ka një farë të drejte ajo? Ruajtja e makinerisë... Cilësia... Duket sikur një farë të drejte e ka.

RUSHKA — Po e them meqë më pyete, shoku Fori.
Ajo ka shumë të drejtë.

NIQIFORI — Jo, more, shumë të drejtë! Se unë dua t'u bëj varrin makinerive. Kështu?

RUSHKA — Jo, këtë mund ta thotë vëtëm një i marrë!

NIQIFORI — Por, ja ku e shpall hapur: po dolëm më poshtë se vjet, le të hapet dheu e të më përpjë mua të parin! Për këtë duhet të luftojmë të tërë. Kurse ajo, meqë jemi grindur dy-tri herë, pret të fërkojë barkun kur ta shohë Niqiforin kokulur! Këtë do ajo! Hm!
Paska shumë të drejtë!

RUSHKA — Ja, shoku Fori... Gabojmë... Mos u çuditni se kaq thellë dhe nuk i shoh dot gjërat... Japim ndonjë mendim të nxituar e pastaj skuqemi kur e kuptojmë.

NIQIFORI — Vazhdojmë. (Thellohen në pasqyrat e

planit.) — Më beso, Rushkë, e ndershme nuk
është, por atë vajzë nuk e dua këtu.

RUSHKA — Si??

NIQIFORI — Kështu është e zonja... Por, e pa-
shtruar, e pabindur. U thye buka midis
nesh... Duhet ose të largohet ajo, ose të lar-
gohem unë!

RUSHKA — O... unë nuk e kuptoj se si mund të
largojeni ju! Kjo është absurde!...

NIQIFORI — Po, po...

RUSHKA — Më falni, shoku drejtor, po sot ju të
bëkeni me zor t'ju kundërshtosh... Ikja juaj
do të ishte marëzi... Merrmani për arrogancë.

NIQIFORI — Atëherë, ajo!... Po nuk ka se si...
Veç po kërkoi vetë. Vetë nuk kërkon...

RUSHKA — Po mbasë e ardhmja...

NIQIFORI — Ç'do të na sjellë e ardhmja?

RUSHKA — Ju, shoku Niqifor, harroni një gjë:
martesën e saj!

NIQIFORI — Martesën e saj?!... E ç'më hyn në
punë mua martesa e saj!?...

RUSHKA — Po ja, i shoqi mund ta shtrojë, ose
mund ta heqë që këtej. Mund të jetë i ar-
syeshëm ai.

NIQIFORI — Ama, muhabet! Çfarë, mblesëri do të
bëjmë tanë?! Phë! Po sikur ai i shoqi të
jetë ndonjë qyp... kokëgdhë?

RUSHKA — Oh! Nuk ma merr mendja.

NIQIFORI — Seç të tërheq në ca biseda ti, Ru-
shkë. (*Merr në dorë pasqyrat.*) Ah, po!...
Të kemi fat ta marrë ndonjë i largët.

RUSHKA — Pse i largët?!

NIQIFORI — Larg, larg... Në ndonjë qytet tje-

ter... Këtë urim e bëj unë... Këtë dua...
Vazhdojmë!

RUSHKA — Vazhdojmë!

Troket dera.

NIQIFORI — Hyr!

Nuk hyn askush. Prapë trokitje.

NIQIFORI — Hyni, ju thashë!

Dera hapet pak nga një dorë e pavendosur.

NIQIFORI — Po hë, de... Kush është?

RUSHKA — (*Shkon te porta.*) Është nipi juaj,
Aleksi.

NIQIFORI — (*Në largësi, meqë ende nuk e sheh.*)

*Prapë ti?... Ke bërë ndonjë prapësi?... Fu-
tu, futu, shoku punëtor.*

(*Hyn Leksi.*)

LEKSI — Mirëmëngjes... shoku drejtor!

NIQIFORI — Përse ke ardhur, mor djalë?... Va-
zhdon kërkësen për të ndërruar vendin e pu-
nës? Nuk të pëlqen remonti?

LEKSI — Jo... Dua të them, po megjithëse ka
plasur puna vu!... Jam pa fat...

NIQIFORI — Dëgjo, nuk jam fallxhore unë... Kam
fat, nuk kam fat... Bjeri shkurt!

LEKSI — Mua, shoku drejtor, inxhinierja e remon-
tit më ka inat...

NIQIFORI — Ma ke thënë që të ka inat.

LEKSI — Tani mund të them, më urren!

NIQIFORI — Vërtet, more?! E nga e kuption ti
këtë gjë.

LEKSI — Kuptohet menjëherë... Mbrëmë më cak-
toi në turnin e tretë dhe nuk miafton kjo,
po më zuri duke fjetur.

NIQIFORI — Ashtu?! Duke fjetur?!

LEKSI — Po... Dhe më dëboi nga puna... Pas mesit të natës.

NIQIFORI — Domethënë të ka inat?

LEKSI — Shumë... Dhe e kuptoj, sepse... Ma bën enkas...

NIQIFORI — Ajo të vuri në gjumë?

LEKSI — Jo, fjeta vetë.

NIQIFORI — Ore, mos më luaj budallanë këtu...

Na thënke përralla në të gdhirë! E përse të paska inat?

LEKSI — Unë e kam kuptuar.

NIQIFORI — Pa hë, ta dëgjojmë.

LEKSI — (*Sheh nga Rushka.*) Po nuk di a ta them?...

NIQIFORI — Hë, more, thuaje!... Ndonjë budalllek do të kesh.

RUSHKA — Po të doni dal... Po të doni zereni se s'jam...

NIQIFORI — Rri sikur nuk je.

LEKSI — Hyra një ditë në zyrën e saj... I fola po nuk e kishte mendjen... Fliste në telefon... I fola, prapë ajo hiç... Bisedonte me një djale.

NIQIFORI — Ç'na thua, more... E ku ishte ky djale? Prej nga ishte?

LEKSI — Unë nuk e pashë djalin. Pashë vetëm telefonin.

NIQIFORI — Fliste afër apo larg?

LEKSI — Pa prisni... (*Rikuhton.*) «Mirë pasdite, ku? Në hyrje të parkut. Më mirë nesër» Afër, afër... Duhej të ishte që këtej.

RUSHKA — Nuk ka mundësi.

LEKSI — Ka mundësi. Pastaj ajo u kthye, më pa

dhe u skuq... Pse u skuq ajo?! Dukej që...

NIQIFORI — Që çfarë...

LEKSI — Që... diçka ziente!...

RUSHKA — Ziente?

LEKSI — Ja, që atë ditë më ka marrë inat.

NIQIFORI — Kurse ti the se e zure xholin, e vure festen mbi sy se i di sekretin dhe ia këput gjumit...

LEKSI — Më beso, dajë... shoku drejtor, e kam nga mërzia. Ju po të doni... Janë disa karro elektrike... është ajo jeshilja.

NIQIFORI — Do të të jap një karro të kuqe që të ikësh dhe të mos kthehesh më. (*Hap sirtarin mekanikisht*). C't'i bëj, është edukimi në plan të parë, pa llafoleshim bashkë!... Dil përjashta e vazhdo punën se do ta zgjidh unë problemin tënd. mos u bëj merak.

LEKSI — Dajë... shoku drejtor.

NIQIFORI — Përjashta, të thashë, se ta vërvita këtë sirtar kokës!

Leksi del.

NIQIFORI — Rushkë, largohu... Pasqyrat leri. Pas gjysmë ore më fillon mbledhja. Do të raportoj... Pastaj ato pompat... Duhen futur në prodhim... Uh! Më jep një mendie.

RUSHKA — Një mendie... Si urdhëron, shoku Niqifor. Një mendje... Po ja. sikur t'i fillojmë. po kështu avash avash pa i deklaruar... Ato aë të prodrojmë këtë vit i dorëzojmë vitin tjetër... Kështu dhe këtu i kënaqim që filluam. dhe planin nuk e prishim. dhe përvitin që vien krijojmë rezerva...

NIQIFORI — Miaft.

RUSHKA — E lashë...

NIQIFORI — Për mashtrime nuk më ke mua!...
Më mirë drejt... Trembem për planin.

RUSHKA — E lashë... Fjala juaj e ka peshën
të rëndë. (Del.)

NIQIFORI — (*Duke mposhtur zemërimin.*) Këshi-
llat e tua, Rushkë, janë si gotat e rakisë
për alkoolistin, që edhe ia do shpirti, por
ama e din shumë mirë që i bëjnë dëm.

Hyn Shefqeti. Mirë që erdhe, Çeço. Kemi
kohë derisa të fillojë mbledhja... Dalim pi-
më një kafe. (*Shefqeti nuk flet. Ashtu i*
ngrysur nis të dredhë një cigare.) Kam një
dhembje koke... Një kafe do të më lehtë-
sonte. (*Shefqeti nuk flet.*) — Çeço! Shefqet!
Si e ndien veten?

SHEFQETI — (*Pasi ia ngul sytë Niqiforit.*) E vërt-
tetë?

NIQIFORI — Kush?

SHEFQETI — Ajo.

NIQIFORI — Cila ajo?

SHEFQETI — Ajo që më thanë. Më thanë se ke
fyer rëndë inxhinieren.

NIQIFORI — Inxhinieren? Fyer? Rëndë?

SHEFQETI — Po... E ke bërë këtë, Fori?!...

NIQIFORI — T'u ankua ajo?

SHEFQETI — Ajo mund të mos ankohei dhe pro-
blemi përsëri qëndron... Nuk duhet të si-
llesh kështu, Fori! Është titura tregon pa-
aftësi.

NIQIFORI — Avash, Çeço, avash...

SHEFQETI — Unë dua të them se... (*Shikon përqark.*) Ore, pranon të t'i them këtu apo
të të thërras në...

NIQIFORI — S'ka gjë! Thuaji këtu ato që mendon ti.

SHEFQETI — Mos të është rritur mendja?

NIQIFORI — Ouuu!... Dhe këtë ma the?!

SHEFQETI — Mos të ka pushtuar vetëkënaqësia?

NIQIFORI — Vetëkënaqësia mua?!

SHEFQETI — Kapadaillëku?

NIQIFORI — Ou!

SHEFQETI — Kush të lejon ty t'i fyesh të tjerët?!

NIQIFORI — (Ngrihet.) Kjo nuk durohet... Unë të propozoj për kafe... Këto s'kanë hiç lidhje me kafenë!... Këto nuk m'i mban kurrizi. I shtrojmë në mbledhje...

SHEFQETI — Dua të sqaroj diçka. Pa filluar mbledhja...

NIQIFORI — Unë nuk e kuptoj c'po ndodh këtu... Në vend që t'i gëzohemi flamurit, më shumë telashe.

SHEFQETI — Flamuri jepet për të ecur përpara. Po të ishte për të fjetur do të na jepnin jastëk.

NIQIFORI — Nuk jam i jastëkut e i dyshekut unë, e ti e di mirë... Më rreshton një thes me të meta... Këtë nuk ta pranon logjika... A mund të ketë ndërmarrje me flamur një drejtor me kaq të meta?

SHEFQETI — Jo.

NIQIFORI — Po atëherë unë?

SHEFQETI — Përjashtim.

NIQIFORI — Aaa... ashtu?!

SHEFQETI — Ashtu.

NIQIFORI — Domethënë kështu?!

SHEFQETI — Tamam kështu.

NIQIFORI — Po atëherë dhe ti nuk duhet të jesh në rregull.

SHEFQETI — Po, natyrisht... Se kemi ne, pa ke dhe ti...

NIQIFORI — E bukur kjo!... E pranon. Hë, të pifsha dollinë! A e kuption se ç'na thua?... Ti po thua se i është dhënë flamuri i garave një ndërmarrjeje që ka drejtorin të... të krimbur me të meta, kurse sekretari dhe organizata nuk janë në rregull...

SHEFQETI — Avash, ti, avash, se aq sa po e bën ti nuk jemi, de!... Së pari, drejtori nuk është aspak i krimbur, por duhet ruajtur nga krimbi, kurse...

NIQIFORI — Po atëherë flamurin e meritojmë.

SHEFQETI — Po s'do mend. Se kemi prodhime të mira, me cilësi, kemi rendiment.

NIQIFORI — Çorbë ma bëre të shkretën! E meritojmë apo nuk e meritojmë?

SHEFQETI — Për ata që na e dhanë, ne e meritojmë; për vete, ne kemi akoma punë që ta meritojmë... Ja, kështu duhet menduar, them unë.

NIQIFORI — E qartë... E përse erdhe tek unë?

SHEFQETI — Që të vërtetoj se ti i ke thënë asaj vaize fjalë që nuk i mban kandari.

NIQIFORI — (Prerë.) I mban kandari!

SHEFQETI — Ashtu?

NIQIFORI — Po tani varet nga kandari.

SHEFQETI — Fori, leri lojrat. E pranon që e ke fyver?

NIQIFORI — Jo. (Në telefon.) Më thërrisni pak shokun Rushkë! (Mbyll telefonin.) Ai ishte këtu.

SHEFQETI — Unë nuk kisha ndër mend të bëja ndonjë ballafaqim, o Fori, po meqë thirre Rushkën, thirr edhe Valmirën.

NIQIFORI — Përse Valmirën, ajo nuk të është ankuar.

SHEFQETI — Paçka. Unë do ta pyes.

NIQIFORI — (*Merr telefonin.*) Po tani ajo është e qartë... Asaj shyqyr që do t'i jepet rasti para mbledhjes së byrösë... pu pu! Ec e dëgjoje atë tani! (*Në telefon.*) Më thërrisni in-xhiniere Valmirën. (*E myll telefonin.*) Ajo fle, ne shkojmë dhe e zgjojmë. (*Vërtitet në-për zyrë.*) Nga më kumbisi këtu kjo...

SHEFQETI — Fori!

NIQIFORI — Të lutem, Çeço, ta them kështu...
Po lemë të ta them... Se mos ma ngresh si problem... S'më hyn dot këtu. (*Ve dorën në gjoks.*)

SHEFQETI — Ti as nuk e kupton dot se ç'vajzë është ajo!

NIQIFORI — Mor, e kuptoj, po u thye! Tani mezi ç'pres që të më ikë, të martohet e të ma marrin... E po vajzat martohen, mos u çudit ti!... Unë nuk e mbaj dot.

SHEFQETI — Mungesën e saj do ta qaje ti, po ç't'i bësh, e ke prandaj...

NIQIFORI — E kam. Dhe do ta kem gjithmonë. Nuk martohet kjo, jo...

SHEFQETI — Nuk dihet.

NIQIFORI — Mjerë atij që do t'i zerë derën!

SHEFQETI — Do ta bëjë të lumtur.

NIQIFORI — Dasmën e kësaj unë e imagjinoj me mot të vrenjtur ... Shi!... Bubullima!... Na-

tën e parë kjo të ve fletë-rrufe në kokë të krevatit... Ti i thua: nusja ime, eja të të përqafoj... Ajo do të të thotë: Nuk e përmban grafiku!

Troket dera. Hyn Rushka.

NIQIFORI — Ja Rushka! Urdhëro, pyete!

SHEFQETI — Rushkë, a ishe ti i pranishëm në zënkën midis drejtorit dhe inxhinierës?

RUSHKA — Urdhëro?

SHEFQETI — Ishe i pranishëm në zënkën midis shokut Niqifor dhe shoqes Valmira?

RUSHKA — Jo.

SHEFQETI — (*Niqiforit*). Po ç'na e thërret këtë?! Ky nuk paska qenë.

NIQIFORI — (*Rushkës*) Dale, more ti! Nuk ishe që parë këtu?

RUSHKA — Isha.

NIQIFORI — E po pse ia këput zdrënkti e thua nuk isha?

SHEFQETI — Nuk bëjmë shakara këtu!

RUSHKA — Më falni, unë isha kur biseduan... Ndonjë zënkë nuk di të jetë bërë në prani-në time.

NIQIFORI — Po tamam, se u hutova dhe unë... S'pat zënkë këtu... Drejt e ka Rushka.

RUSHKA — Biseda ishte krejt e zakonshme, shoku Shefqet.

SHEFQETI — Kështu, ëh?

RUSHKA — Absolutisht kështu!

NIQIFORI — E shikon, Çeço?

SHEFQETI — (*Rushkës*) Ti thua se Niqifori nuk i bërtiti.

RUSHKA — Kush tha që nuk i bërtiti?

SHEFQETI — Ti. The që biseda ishte krejt e zakonshme.

NIQIFORI — Ashtu the, o të mori lumi!

RUSHKA — Thashë e zakonshme... e zakonshme, se shoku Niqifor zakonisht bërtet... Ja, dhe mua më ka bërtitur... Nuk ankohem, absolutisht. Bile mund të them që të bërtiturat e tij janë mobilizuese, janë... frymëzuese, janë...

Troket dera dhe hyn Valmira.

SHEFQETI — Hajde, Valmira... Hë, Rushkë, si janë?

RUSHKA — Ja, i thashë... E tepërt t'i përsëritim.

SHEFQETI — Asgjë s'mora vesh... Të bërtitura pati, po zënka jo... E çuditshme.

RUSHKA — S'ka asgjë për t'u çuditur, shoku Çeço... Zenkë quhet kur shkëmbenen bërtitje nga të dy palet... Po a mund të bërtasë inxhiniere Valmira? Ajo është një vajzë e edukuar.

NIQIFORI — Ka një lloj krenarie që...

RUSHKA — ...e edukuar me krenari, po e qetë, e sjellshme, e...

SHEFQETI — Ore, Rushkë, nuk të merret mendja ty me gjithë këto kthesa?! Shkurt, more shok, na ndihmo vetëm me një përgjigje: e fyeu drejtori inxhinieren apo jo?

Pauzë. Të gjithë presin Rushkën.

RUSHKA — Hm... Po... Unë e njoh drejtorin tonë prej njëzet vjetësh...

NIQIFORI — Ore, do të përgjigjesh ti apo do të më bësh biografinë?! E fyeva apo nuk e fyeva?

RUSHKA — Jo... m'u duk se jo!

Pauzë.

SHEFQETI — Tefta thotë po, ty të duket jo...
Mirë, t'i kthehemë Valmirës. Moj inxhinierë,
po t'i ç'pate që nuk erdhe tek unë?

VALMIRA — Ngutesha se kisha dy torno...

NIQIFORI — Drejt, drejt... Ajo mori urdhër që
dy tornove t'u anulonte remontin...

VALMIRA — Unë nuk anulova asgjë... Fillova
dhe dy të tjerat.

NIQIFORI — Shumë bukur! Mbarësi!

VALMIRA — Dhe ju sigurojmë, shoku Çeço, orga-
nizatën dhe drejtorinë, se meqë uzina ka
nevojë të ngutshme, do bëjmë natën ditë
e do t'i përfundojmë në kohë rekord, besoj
rreth pesë ditë para afatit.

SHEFQETI — Ju lumtë! Bëre mirë që shkove më
parë në punë se sa të filloje ankesat, por
prapëseprapë kjo gjë duhet sqaruar... Për
ne është shumë e rëndësishme, prandaj po
pate ndonjë ankesë, shkurt, po të pati fyer...

Pauzë e rëndë.

VALMIRA — Nuk kam asnijë ankesë... Nuk më
ka fyer.

RUSHKA — (Merr frymë lirisht.) Këto djersët mua...
Niqifori ka mbetur i shtangur.

SHEFQETI — Mirë, ju faleminderit... Shkon meqë
keni punë...

Valmira dhe Rushka përshëndesin dhe dalin.

RUSHKA — (Në korridor, Valmirës.) E kuptova pse
the jo... (Valmira buzëqesh dhe largohet).

Në zyrë.

SHEFQETI — Fori, ç'ke?

NIQIFORI — Unë nuk e marr vesh përse tha ashtu?

SHEFQETI — Epo, tha të vërtetën.

NIQIFORI — Ç'të vërtetë, more! Ajo gënjeu si sytë e saj! Ti i the që ishte e rëndësishme, domethënë mund të merrej ndonjë masë përmua. Ajo e mohoi. Ec e kuptoje.

SHEFQETI — Me një fjalë ti e fyeve?

NIQIFORI — E fyeva si hajvan që merr revan!...

Mora flakë si pushka e qorrit! Atë vajzë unë nuk e lexoj dot. Fare, fare, fare. Dhe si mund të punojnë bashkë dy veta që nuk kuptohen, nuk ma ha radakja. Këtu, ose ajo nuk është në rregull...

SHEFQETI — Ose ti!

Fundi i tablosë së dytë

TABLO E TRETE

Mbas disa ditësh.

Një rrugë. Po ngryset. Shkëlqimi po pret Valmirën. Në anën tjetër shfaqet Rushka. Ai e shikon Shkëlqimin me dyshim. Pastaj i kalon para hundëve, por ai nuk e sheh. Kalon përsëri e ai përsëri nuk e sheh. Shkëlqimi vështron orën. Pas tij orën e vështron dhe Rushka. Ndjeq shikimin e Shkëlqimit dhe më pas i afrohet për herë të tretë, pa u vënë re përsëri.)

RUSHKA — (Befas.). Ou, doktor!... Si jeni?

SHKËLQIMI — Tungjatjeta, shoku Rushkë.

RUSHKA — Ju pashë dhe po thosha: është doktori — s'është doktori? Për pak do të kaloja pa ju folur... Dhe ju e dini, mungesa e vëmendjes shpesh interpretohet si kryelartësi.

SHKËLQIMI — Ooo, po do t'u flisja unë!
Shikon përqark. Rushka i ndjeq shikimin.

SHKËLQIMI — Si ia kalon me punë?

RUSHKA — Punë plot... Detyra të mëdha... Nata-ditë! Po q'të flas unë... Shikoni babanë tuaj! Shembulli i tij, do, s'do, të merr me vete.

SHKËLQIMI — (Pa e pasur mendjen.) Po, po... hm!

P a u z ë.

RUSHKA — Njerëzit si babai juaj, për nder, sikur nuk janë gatuar me mish e kocka, por me hekur. Çelik e fibër, ja kjo do t'i shkon te më saktë... Nuk kursehet absolutisht as-pak... Dhe ne, njerëzit e tij më të afërt, duhet ta kemi parasysh këtë.

SHKËLQIMI — Sigurisht, sigurisht.

RUSHKA — Unë nganjëherë ia bëj harbutshe... Se kemi shumë miqësi bashkë... Unë dhe ai atje! «Mjaft. Fori, — i them, — s'të le më sikur dhëmbin kaq ta bësh!»... Dhe ia marr dokumentet e ia mbyll me çelës. Një ditë e nxora nga zyra duke e shtyrë... U nxeh, po punë e madhe... Dhe tanë çoku ruhet nga unë... Prisni njeri kështu?

SHKËLQIMI — Urdhëro... Ah, po... Pres një shoqe.

RUSHKA — Shoqe?!

SHKËLQIMI — Po, por vonoi shumë.

P a u z ë.

RUSHKA — E po juve ju dalin punët papritur. Mjeke është?

SHKËLQIMI — Jo, nuk është mjeke.

RUSHKA — Nuk qenka mjeke. (Pauzë.) Po ç'e do, atje nuk sillen të gjithë si unë... Ka ca që

ia ngrejnë sho... Forit, nervat në qiel. Eshtë për shembull një inxhiniere...

SHKËLQIMI — Inxhiniere!?

RUSHKA — Një vajzë që s'para ta mbush synë... Si i thonë... Ia harrova dhe emrin se ka plot atje.

SHKËLQIMI — (*Pa dashur.*) Valmira.

RUSHKA — E njihni?

SHKËLQIMI — Jo... Dua të them po... E hamë nga një pëershëndetje kur takohemi... Se qëllon që takohemi...

RUSHKA — Ashtu? E, pra, këtë vajzë babai juaj nuk don ta shohë me sy.

SHKËLQIMI — Kam dëgjuar diçka

RUSHKA — Rri dot zjarri me benzinën?... Prania e saj babait tuaj i humb qetësinë, i prish gjakun, i shkurton jetën. «Më beso, i shtrenjti Rushkë, — më tha një ditë, — zgjidhja eshtë vetëm martesa e saj!»

SHKËLQIMI — Martesa... Po kjo eshtë shumë e thjeshtë!

RUSHKA — «Veç sa më larg, — tha, — larg». Kjo eshtë dëshirë e tij... Ma tha copë... Po pinimi nga një gotë bashkë.

SHKËLQIMI — Babai nuk pi.

RUSHKA — Më bënte shoqëri mua... Dhe kjo dëshirë, e shoku Fori sikur nuhatet... Eshtë atje në uzinë një djalë i mrekullueshëm... me shpirt të lartë, një person i përsosur, kur i thonë... E do vajzën, por nuk ia thotë vetëm për shkakun që thashë!

SHKËLQIMI — Po ajo?

RUSHKA — Ajo... Hm... Dhe ajo e do... Dhe

ajo... Kuptohet menjëherë. Shenjat duken sheshit... E në fakt kushdo që t'i shohë do të thotë: këta i ka krijuar natyra për njëri-tjetrin... Po as ai, as ajo nuk e shfaqin... (Pauzë.) E di, babai im nuk iu heq nga goja.

SHKËLQIMI — (*I hutuar.*) Ah, po, po... Patjetër. RUSHKA — Ka mbetur mjaft i kënaqur nga vizita dhe nga kura që i dhatë. (Pauzë.) Edhe s'kemi kohë po duhet të kujdesemi për prindërit... Ata janë si të thuash,... krejt në dorën tonë... Kujdesi ynë nuk duhet t'u mungojë...

SHKËLQIMI — Natyrisht... Ata... ata janë e ardhmja.

RUSHKA — E ardhmja!

SHKËLQIMI — Lu-le... Lule... Ju sa keni?

RUSHKA — Sa?!... Dy, sa të kem!

SHKËLQIMI — Se disa kanë nga pesë, nga gjashëtë... Një kolegu ynë, ka tetë.

RUSHKA — Prindër?!

SHKËLQIMI — Pri... Po flas për fëmijët!

RUSHKA — Aa, u keqkuptuam. (*Qesh.*) U keqkuptuam.

SHKËLQIMI — Po, vërtet, shoku Rushkë... Ju sa fëmijë keni?

RUSHKA — Unë? Fëmijë?!. E dini.

SHKËLQIMI — Ah, më falni... E mora vesh... Nuk lindni... Sa kohë keni i martuar?

RUSHKA — Nuk jam martuar ende.

SHKËLQIMI — Akoma i fejuar?

RUSHKA — (*Me një farë inati.*) Unë jam thjesht djalë. Natën e mirë. (*Niset të largohet.*)

SHKËLQIMI — Natën e mirë... Natën e mirë.

(Duke shpejtuar t'i dalë përballë Valmirës.)
Natën e mirë, i dashur!

RUSHKA — (Si i mpirë.) S'më paškan gënjenet she-njat. Ajo vetë... C'e gënjen mendja të gjorin doktor të zemrës! Pa le kur ta marrë vesh shoku Niqifor... (Tërhiqet të përgjojë.
Shkëlqimi vjen me Valmiren.)

SHKËLQIMI — Mirka, ç'ke? Më dukesh e lodhur...
Unë të prisja që këtej nga shtëpia.

VALMIRA — Po vij nga puna dhe bille shumë e lodhur.

SHKËLQIMI — Eja të çlodhemi (*Shikon përqark.*)
Hë, ja një stol aty në park. (*Vajza nuk lëviz.*)
Eja! Ç'ke? Ti nuk më dukesh mirë... As
nuk më përqafove si zakonisht... Mos të ka
ndodhur ndonjë gjë këto ditë?

VALMIRA — Çdo gjë e kemi së prapi... Pse vallë,
mos do të ishte më saktë të ndaheshim?

SHKËLQIMI — Të ndahemi?! Ne të dy?! Pa eja
në vete! Ne të dy??!

VALMIRA — Po.

SHKËLQIMI — Këto janë marrëzira! Të ndahem
unë nga ty... Kurre! Të ndahesh ti nga
unë... Po a ka forcë t'ia arrijë kësaj?

VALMIRA — Mjerisht më duket se po...

SHKËLQIMI — Do ndonjë tjetër?

VALMIRA — (E godet me grusht.) Ee! Mati fjalët!
SHKËLQIMI — Kështu më përralloi ai që iku.

VALMIRA — Rushka? Ti e beson atë.

SHKËLQIMI — Fare! Po ç'të them. Ndonjë intrigë
për mua. Dhe ti, Mirkë...

VALMIRA — (E godet përsëri.) Intrigat nuk zenë
vend tek unë.

SHKËLQIMI — Po atëherë? Çfarë s'vete mbarë?
Pa t'i marrim gjérat me radhë: a të pëlqej
unë?

VALMIRA — Shumë.

SHKËLQIMI — Qyteti ynë?

VALMIRA — Nuk ka më të bukur!

SHKËLQIMI — Profesioni im?

VALMIRA — I mrekullueshëm.

SHKËLQIMI — Po çfarë s'të pëlqen atëherë?

VALMIRA — Drejtori.

SHKËLQIMI — Drejtori im?

VALMIRA — Jo, i imi.

SHKËLQIMI — Babai?!

VALMIRA — Po... Më nënveftëson... S'më përfill... Më fyen... Unë për të nuk vlej fare.

SHKËLQIMI — Qetësohu... qetësohu!

VALMIRA — Sa të pafat që jemi!

SHKËLQIMI — Budallaqe! E pse pa fat?

VALMIRA — Ah! Sikur të mos e kisha drejtor.

SHKËLQIMI — Shumë më mirë do të ishte.

VALMIRA — Ose le ta kisha drejtor, po të paktën,
të paktën... shkurt, gjëja më ideale do të
ishte po të mos qe babai yt.

SHKËLQIMI — Po i kujt?

VALMIRA — S'ka rëndësi! I yti të mos ishte.

SHKËLQIMI — Eeej, Mirka! Mos bëj hamendje në
tym! Babai im është babai im! Dhe dëgjoje
përfundimisht: nuk ka më të mirë se babai
im! Zemrën si të...

VALMIRA — Ai s'ka zemër, por një copë akull!

SHKËLQIMI — Jo akull, po prush, prush e ka
zemrën për njerëzit ai... Po unë, moj e

dashura ime, kam baba tepër të ngatërruar... E kam inatçى, e kam sedërmadh, e kam fjalërëndë, të ashpër... Ai u ngjan atyre frutave të tharta, me gjemba, që dielli dhe koha i pjekin nga brenda e ata bëhen të ëmbël po lëkurën e ashpër nuk e hedhin që nuk e hedhin... Sikur u vjen turp... Dhe më beson? Dhe mua sepse më pëlqen këshfu... E pe sot në punë?

VALMIRA — Disa herë.

SHKËLQIMI — Ka hallin e atyre pompave që ju do t'i futni si prodhime të reja...

VALMIRA — Më në fund!

SHKËLQIMI — Doli enkas për to... Por nuk duhej të dilte... Duhej të pushonte... Ai më kishte lënë hijen... I telefonova. Më tha: ç'më çan kokën!... Porosita drejtorin tim ta kërkonte në telefon... Babai kishte porositur të vetët që të thoshnin se shoku Niqifor është me pushime në kampin e Dardhës. Ja çfarë çapkëni është babai im! Dhe unë babanë tim nuk do ta ndërroja me asnje tjetër!

VALMIRA — Unë e di këtë. E di. E di.

SHKËLQIMI — (Ngrohtë.) Unë as nusen time nuk e ndërroj!

VALMIRA — Ti mund t'ia dërosh huget atij.

SHKËLQIMI — Unë nuk ia duroj hiç.

VALMIRA — Po mbasë nuk ia prish qejfin e nuk zihesh me të...

SHKËLQIMI — Në shtëpinë tonë nuk zihemi vetëm kur flemë... Prandaj, e dashura ime, qetësohu. Ne do të bashkohemi të lumtur...

VALMIRA — ...Ti harron krenarinë time... Kur ta

marrë vesh ai do të mendojë që unë... Do
të mendojë keq për mua.

SHKËLQIMI — Do t'ia shpjegoj unë.

VALMIRA — Dhe në u bashkofshim ne të dy, gjë
që rrezik... rrezik se...

SHKËLQIMI — Tani më duket do të qaj unë!

VALMIRA — Dhe në u bashkofshim, ne do të
bashkohemi, veç po të vijë të më kërkojë
për nuse drejtori.

SHKËLQIMI — Drejtori im?

VALMIRA — (Nervoze.) I imi! Babai yt! Bile të
ma theksojë: «Të dua nuse për djalin. Të
lутем, prano, se ti je tamam nusja që i du-
het djalit tim».

SHKËLQIMI — Këtë ai nuk e bën kurrë!

VALMIRA — E di që nuk e bën!... Ndryshe do
të më duket sikur hyj në shtëpi me zor...
(E trishtuar.) Çdo gjë është ndërthurur ters.

SHKËLQIMI — Ti duhet të ulesh, se je e lodhur!

VALMIRA — C'të them unë e ç'thua ti!

SHKËLQIMI — Flas në emër të dashurisë sonë.

VALMIRA — Jo.

SHKËLQIMI — Flas në emër të mjekësisë, në emër
të kujdesit për shëndetin e punonjësve të
dashur... Shumë të dashur e të shtrenjtë!

VALMIRA — Në emër të mjekësisë, po, pranoj.

Niset drejt parkut. Shkëlqim i kap krahun. Valmira, ende e nxehur, i shmanget. Shfaqet përsëri Rushka. Ai i ndjek me sy.

RUSHKA — Ajo i tregon vendin... Të lumtë, Val-
mirkë! Le të guxojë më shumë po të dojë...
Unë jam këtu, për mbrojtjen tënde... Pre-
ke më, po ta mbajti, o doktor i zemrës. Ne-

sër nuk do ta shohësh veten në kardiologji,
po në kirurgji dhe bile pacient i katandisur
keq... Ua! Po kjo punë?! Tani po i hedh
dorën ajo... Aaaaa! Ajo e përqafoi... E ka
gënjer. E ka mashtruar, i poshtri!

Fundi i tablosë së tretë

TABLO E KATERT

Një shesh në uzinë përpara zyrës së Niqiforit. Disa punëtorë kalojnë duke biseduar. Hyn kronisti i radios.

KRONISTI — Më falni, drejtorin desha, shokun Niqifor!

BASHKIMI — Unë nuk e kam parë!

KRONISTI — Uf... Më këputi sot gjithë ditën!... Intervistën me punëtorët e mbarova, kam edhe diçka me të dhe i jap fund... Kam pér të bërë edhe njëqind kilometra rrugë.

REXHEPI — Maratonist je?

KRONISTI — Jo, vij nga radioja.

BASHKIMI — Shiko, se e keni me raport...

KRONISTI — E di... I shkuam në shtëpi... Na thanë erdhi në punë... Nga zyra kishte dalë... Nga remonti kishte ikur... Uf!...

BASHKIMI — Sot nuk e kam parë!

KRONISTI — (Me shaka, konfidencial.) Opo, troc hësapi! Ekziston ky njeri, apo jo?

BASHKIMI — (Qesh.) Ekziston, mos u bëni merak!
(Guros.) Guro, shoku Niqifor...

GUROJA -- (Duke hyrë) Para një ore e pashë në linjën e pompave.

KRONISTI — (Me ngut.) Në linjën e pompave?
Faleminderit, mik... Mirupafshim e punë të mbarë! (Del.).

Hyn Niqifori.

NIQIFORI — Hë, Bashkim, mbaruat me remontin?

BASHKIMI — Edhe pak. Ndërkokë po përfundojnë edhe instalimet dhe shoqja Valmira do të vijë t'ju raportojë në zyrë.

NIQIFORI — (Në qejf.) Valmira, moj Valmira. Ty të marrtë e mirë! Në zyrë! Ka qejf të më raportojë ca si zyrtarisht, demek! Hajd se po ia durojmë. Tornot po na i dorëzoni gjashtë ditë para afatit... Ia zbardhët faqen çupës! E po i hëngshim dasmën!

REXHEPI — E kemi të mirë, shoku drejtore.

NIQIFORI — Çka! Është aty midis dhisë dhe mushkës! Do të më raportojë në zyrë! Po e pres në zyrë. (Niset.)

GUROJA — (Duke kaluar.) Shoku Niqifor, një shok nga të radios të kërkon.

NIQIFORI — A, për në radio jam unë! Mua po më zien koka... Pastaj, nuk më shkojnë shumë pozat mua.

Punëtorët dalin. Hyn kronisti.

KRONISTI — (Niqiforit.) Mos ua ka zënë syri shokun Niqifor?... Na duhet për një radioreportazh...

NIQIFORI — Po nuk e njihni ju shokun Niqifor?

KRONISTI — Jo!

NIQIFORI — Fare?

KRONISTI — Fare!

NIQIFORI — Si t'ju them unë...

KRONISTI — U bëra shumë vonë.

NIQIFORI — Po mirë, ik!

KRONISTI — Si thua të iki, pa e ilustruar reportazhin me zërin e tij?!...

NIQIFORI — Po mbasse nuk ju prish punë?

KRONISTI — Tani prish një farë pune, po prapë reportazhi qëndron, se kam biseduar me punëtorët e dalluar.

NIQIFORI — E po, dëgjo... Ik më mirë, se nuk ke gjë. E pashë me sytë e mi nga poliklinika. Ai i gjori po mballoset me gjilpëra!

KRONISTI — (*Duke myllur përfundimisht manjetofonin.*) Ah, unë nuk kam fat. Uf... Dhe më ranë këmbët. Kush e di ç'hiqni ju me këtë drejtor. Ditën e mirë, shok... (Del.)

NIQIFORI — Ditën e mirë!...

Hyn në zyrë. Aty vjen me nxitim Lena.

LENA — Fori! Mirë që të gjeta, se u bëra për ujë e kripë nga këmbët.

NIQIFORI — Nga hyre ti, moj Lena?

LENA — Nga hyjnë makinat... Nga porta...

NIQIFORI — E kush të lejoi?

LENA — Po mua portieri më njeh!

NIQIFORI — Po si duket, nuk më njeh akoma mua... Do t'i përvishem mirë atij portierit tënd!

LENA — Jo, ti përvishju portierit tënd, jo timit!...

Po në vend që të më qash hallin, fillon nga masat për portierin... Se jam një motër e

vetme, pa burrë... Me një djalë akoma të parritur...

NIQIFORI — Mirë, mirë, mirë... urdhëro e fol!

LENA — S'paskam as vëlla...

NIQIFORI — Ja ku më ke, e fol... Fol!

LENA — Nuk flas! Hiç, nuk flas!... Më mirë po takoj ndonjë sekretar a kryeinshinier e ta di që jam fillikat e vetme në këtë botë...

NIQIFORI — Epo do të flasësh tani apo të iki fare unë!... Ou!... Fol, q'ke?

LENA — Për Leksin erdha.

NIQIFORI — Është futur në kumbulla?

LENA — Jo, jo, e kam fjalën pér këtu... Po na e marrin më qafë!

NIQIFORI — Kush, moj!

LENA — Ata... këta... këtu!

NIQIFORI — Ne, moj ne, po e marrim më qafë. Unë e ti.

LENA — Qëkur është futur në uzinë s'ka gjetur rehat... Kritikë, — të shara, të shara — kritikë...

NIQIFORI — Pse, q'pandeh ai?!

LENA — A, bukur! Se është nipi i drejtorit, hiç ata! Bam!

NIQIFORI — Po s'qe në binarë, ata i bien bam, drejtorit, jo më nipit! Pastaj?

LENA — Pastaj, sot kishin përqafuar inisiativën... Njëzet veta në fshat!... E kishte përqafuar edhe Leksi im...

NIQIFORI — Po hë de, le të shkojë se më mori malli ta përgafoj edhe unë njëherë atë e t'i them nip.

LENA — Po dale! Ai nuk do të shkojë!

NIQIFORI — Pse? Ia' kthyen ata?

LENA — Jo, e ktheva unë... domethënë nuk do ta le unë, me një fjalë mos e ler ti!

NIQIFORI — Si të mos e lë unë?

LENA — Ja, për këtë kam ardhur... Të mos e lesh. Na duhet këtu, thuaj, na duhet shumë.

NIQIFORI — Kush na duhet?

LENA — Leksi!... Thuaj: në asnje mënyrë nuk e lë!

NIQIFORI — Mirë thua! Pa të s'bëjmë dot një çap!

LENA — Mbaje dhe hiqe nga ai repart.

NIQIFORI — Do ta ve në llogari.

LENA — Në llogari?!

NIQIFORI — Po, në llogari, se vendin e kryeinxhierit e kam të zenë.

LENA — Epo, çka, fundja e mira s'ka fund. Ika t'i them Leksit... U, mor Fori! Ah, po vëllai-vëlla! (*Ikën me ngut.*)

NIQIFORI — Na, motër! Leni! Lena. Jo, ore, po me të tillë njerëz një kokë eshtë pak. Një duhet që të luash mendsh e një duhet për punën. Pa të shohim ç'na ka sjellë shoku Rushkë... Futjen graduale në linjë të pom-pave të reja... Dhe një letër... Një letër personale të mbyllur në zarf... Ç'janë këto sekrete nga Rushka? Po më parë grafikët... po... A na marrsh pleshtat, o Rushkë... (*I pakënaqur.*) Jo, jo... Shoku Rushkë, ku të shpie ajo mushkë!... (*Duke parë më tej.*) Po jo, mor... mor kungull i ograisur, jo... O, po nuk je thelluar hiç, or çarçaf i nderë në tarracë!... (*Merr telefonin.*) Dua Rushkën... (*Ul telefonin.*) Do të flasim mirë...

Pa t'i shohim këto sekrete që na ke dërguar... (*Shqyen zarfin*).

«Shumë i dashur, shoku Niqifor!

Duke respektuar shqetësimin tuaj në lidhje me martesën eventuale të shoqes V. ing. rep-rem, ... («Eh?... C'është kjo V-ing-rep-rem? A, a... a... Valmira... inxhinire e repartit të remontit. Është në vete ky?... Shqetësimin tim?. Mooreee! Po ky ka roitur!) (*Vazhdon të lexojë*). mbas vëzhgimesh të kujdesëshme të bëra vetë, konstatova se shoqes V. ing. rep-rem, i është qepur...» (Pa shiko, Rushka dedektiv!)

Me nervozizëm merr përsëri telefonin.

Hyn Rushka

NIQIFORI — Ulu! (*Rushka ulet*.) C'janë këto që më ke bërë?... Eh?! (*I rrëfen pasqyrat*.) Këto janë shkel e shko! I ndjen si angari ti! Dhe unë dhe ti do t'ua bëjmë hyzmetin, me një këmbë... (*Ia jep*.) Nesër në orën gjashtë të mëngjesit i dua të plota!

RUSHKA — Si urdhëron!

NIQIFORI — Kur?

RUSHKA — Në orën gjashtë të mëngjesit!

NIQIFORI — Ku?

RUSHKA — Në zyrën tuaj. Po, a do të keni dalë në zyrë?

NIQIFORI — Do të dal që në pesë!

RUSHKA — Dhe do t'i keni gati që në pesë! (*Ngrihet të dalë*.)

NIQIFORI — Prit! Tani më thuaj, pse nuk i ke bërë të plota?

RUSHKA — Po ja, shoku Niqifor...

NIQIFORI — Se po merresh me zbulime sekrete!...

(*Merr letrën.*) Se i je qepur ing. rep-remit.

Kush éshtë ky rep-remi? Futbollist hollandez? Po kush të lejon ty, more? Se them unë një budallallëk, ti e merr pér flori safi...

RUSHKA — Martesa e saj...

NIQIFORI — Qepe, more, se do të na qeshin bota... Po si nuk hapet toka... Si nuk hapet parketi të tē përpjë. (*Duke sjellë ndërmend, ç'ka poshtë.*) Poshtë, ç'éshtë?...

RUSHKA — Arshiva!

NIQIFORI — Të... të hapet edhe arshiva, të tē përpjë! Si more merr guximin të më shkrash mua... «Mbas vëzhgimesh të kujdesësh-me, të bëra vetë, konstatova se: shoqes V. ing. rep-remit, i éshtë qepur... eh... i bie më qafë shoku Shkëlqim, biri juaj i vetëm»... eh? Si more... (*Kujtohet*): Eh... kush... kush... kush? Eh? S'kisha arritur deri te ky rrresht...

Bie në karrige tepër i habitur. Rushka përfiton nga habia e tij dhe del pa u ndier.

Niqifori s'flet më asnje fjalë, s'bën asnje lëvizje. Pas pak në zyrën e tij futet Valmira).

VALMIRA — Mirëdita, shoku drejtor! Ju raportoj se remonti i tornove mbaroi... Tornot janë gati...

NIQIFORI — Po... Po e kuptova... Pastaj...

VALMIRA — Pastaj asgjë... Remontin e përfunduan... Tornot janë gati. Kaq kisha...

NIQIFORI — Prit... ç'kemi ndonjë gjë tjetër, të re?... Më fol... Më fol...

VALMIRA — Të flas?... Ç'të flas? Remontin e

përfunduam. Tornot janë gati. Po ju nuk më dukeni mirë, shoku drejtor!... Të hap dritaren...

NIQIFORI — Mos hap asgjë... Të gjitha janë mirë. Kështu siç janë.

VALMIRA — Si e ndieni veten?

NIQIFORI — Jam aq mirë, sa nuk kam qenë kurrë më parë!

VALMIRA — Shoku drejtor, unë dua të largo hem!

NIQIFORI — Si të largo hesh?

VALMIRA — Dua dy ditë leje të shkoj pranë familjes.

NIQIFORI — Dakord. Largo hu... Largo hu! Shko dhe hajde prapë, ja !

VALMIRA — (*Pak e habitur.*) Mirupafshim. (*Del.*)

NIQIFORI — Mirupafshim... mirupafshim, ing. rep-rem që na qenke lidhur me shokun dr. zem. (*Merr përséri letrën e Rushkës dhe vazhdon leximin. Duke lexuar*)... Shkëlqimi biri juaj i vetëm... Bile ekzistojnë dhe snyime të errëta për të mposhtur sedrën tuaj... Kështu, për shembull, duan t'ju detyrojnë që ju të shqiptoni këto fjalë: Të dua nuse për djalin... Të lutem, prano, se ti je tamam nusja që i duhet djalit tim!» (*Flak letrën tutje.*) Ç'më çani kokën. Pse, ç'jam unë! Më detyron dot njeri mua të flas si i teket njërit apo tjetrit?!

Në korridor shfaqet duke ardhur me nxitim, i xhindosur, kronisti i radios.

KRONISTI — (*Te dera, duke marrë frymë me zor.*) Më falni, më falni, po ju qenkeni një... një tip... një tip.

NIQIFORI — Urdhëroni!

KRONISTI — Kush ju lejon ju të talleni me mua?
Çfarë tipi!

NIQIFORI — (Qetë.) Më avash, t'u bëftë tipi. Qe-tësohu!

KRONISTI — (*Duke zbërthyer me nxitim magneto-fonin.*) E si të qetësohem kur edhe kohën e kam të pakët. Ju u tallët me mua! S'kam lënë skutë të uzinës pa bredhur. (*Shfryny.*) Hileqar!... Mashtrues!... (*Në mikrofon krejt i qeshur e i çelur.*) Ja dhe zyra e drejtorit të kësaj uzine pararojë. (*Shtyn dritaren.*) Në zyrë vjen që këtej zhurma e makinave... Këtu na pret jo një zyrtar, po një punëtor i vërtetë... (*Befas.*) Më sabotove emisionin... (*Duke shtypur disa tasta.*) Sabotator!... Nuk do të ta harroj kurrë këtë!...

NIQIFORI — E ç'i luan ato susta atje?... C'pate?

KRONISTI — Më hutove... Kisha harruar të nisja shiritin. (*Nis regjistrimin.*) Ja dhe zyra e drejtorit të kësaj uzine pararojë... Në zyrë vjen zhurma e makinave... Këtu na pret jo një zyrtar, por një punëtor i vërtetë. I qeshur... (*Niqifori qesh.*) e mikpritës... Shoku Niqifor...

NIQIFORI — Urdhëro!

KRONISTI — (*Ndal shiritin.*) Prit! S'je intervistuar ndonjëherë?

NIQIFORI — S'mbaj mend?! Jo, më duket.

KRONISTI — Në vend që të mësosh, lot kukam-shefthi. (*Nis shiritin.*) Shoku Niqifor, (*Niqifori zë gojën.*) duam t'ju pyesim: ç'bëhet tek ju

për të thyer bllokadën e egër imperialisto-revizioniste.

NIQIFORI — E po punojmë edhe ne si gjithë të tjerrët... Llafi vjen si gjithë të tjerët se kanë ndërmarrje në rreth që po ecin e do na lenë në bisht... Se ata s'hanë bar. Duar ne — duar ata! Kokë ne — kokë ata!

KRONISTI — (Ndal shiritin.) Të lutem, konkretisht! S'ma ka qejfi muhabetin!

NIQIFORI — Konkretisht do dal te llafi i parë... Punojmë... Ja, nesër ne fillojmë prodhimin në seri të pompave hidraulike PH 27... Mjaft më! Importimit të këtij artikulli ne i vemë ferrën...

KRONISTI — (Ndal shiritin.) Ferrën?

NIQIFORI — Ferrën!

KRONISTI — Ç'është ferra?

NIQIFORI — Ferra?... Ferrë!

KRONISTI — Shoku Niqifor... Në radio nuk flijet as me ferra, as me driza! Vazhdojmë! «Hidraulike...» është thënë! (Shtyp tastën.)

NIQIFORI — Kështu importimit të këtij artikulli i vumë vizën me bojë të kuqe!

(Kronisti duket i pakënaqur, zë kokën me dorë e i bën shenjë të vazhdojë).

NIQIFORI — S'të pëlqen as kjo? Po të them të drejtën, mua më doli nga shpirti.

KRONISTI — Mirë, vazhdo... (Shtyp tastën).

NIQIFORI — Ky artikull është jashtë planit të vitit. Po edhe planin e vitit, ne patjetër do ta realizojmë si një e një bëjnë dy, si buka që hamë!

KRONISTI — (Ndal shiritin.) More, shoku Niqifor, ti

qenke i patransmetueshëm! Ç'njeri! Një e
një bëjnë dy. Aritmetikë, po bëjmë tanë?!
Po ç'hyn buka këtu, xhanëm?!

NIQIFORI — (Ngrihet.) Ore mik, se po të duroj
shumë!

KRONISTI — Urdhëro!

NIQIFORI — Epo, të duroj ngaqë jam ca fajtor pa-
ra teje dhe s'ke kohë... Do të më lesh të
flas si ma do shpirti, apo jo! Ou! Ç'hyn bu-
ka!... Hyn që ç'ke me të... Se dua të dal-
aty... që dhe bllokadës t'i themi plaç!... Dhe
po nuk realizuam planet, harram buka që
hamë!

KRONISTI — (I zbutur.) Mirë, mirë mos u nxeh!
Se do ta bëjmë mirë... E di ç'je ti?

NIQIFORI — Hileqar! Mashtrues! Sabotator!

KRONISTI — Artist! Unë shyqyr që të gjeta.
Vazhdojmë!...

Fundi i tablosë së katërt

TABLO E PESTE

Në apartamentin e Niqiforit. Buzë mbrëmje. Përgatitet tryeza e festës së pesëdhjetëvjetorit të Niqiforit... Erifili dhe Lena shpien pjatat në dhomën ku është shtruar tryeza.

ERIFILI — Oi, të lumshin duart, moj Leni... Zor se do t'ia dilja pa ty... Kur të vijnë njerëzit, ne dō të kemi mbaruar.

LENA — (Ndalet para televizorit.) Fili!... Fili... Ferma e Leksit, perimorja... Mos shohim Leksin, iu bëftë mamaja...

ERIFILI — (Ndal edhe ajo me pjatat në duar.) Serat!... Në serat punon Leksi...

LENA — Cave u ecën fati, dalin gjithmonë. Leksi hiç...

ERIFILI — Fati?!... Ah, moj Leni, dhe ti...

LENA — Pse, sa qe në uzinë doli në televizor? Asnjëherë!... Uzina dilte çdo dy javë... Ai s'qëllonte...

ERIFILI — S'ka gjë, do të dalë edhe ai. Kryesorja

është që tani punon mirë... Doli pularia...
Në pulari nuk është, apo jo...

LENA — Ku dihet, mbasse qëllon duke shëtitur kë-tej... Hiç!... Më ka marrë malli...

ERIFILI — Do ta shikosh sonte... S'rri pa ardhur
në pesëdhjetëvjetorin e dajë Forit...

Lëvizin. Zëra në korridor.

SHKËLQIMI — Mama!

LENA — Shkëlqimi.

ERIFILLI — Hë, bir i mamasë, erdhe?

SHKËLQIMI — Mama, kam sjellë Valmirën!

Të dyja gratë mbetën me pjata në duar.

LENA — (Nën zë.) Ka sjellë Valmirën!

ERIFILI — E zeza unë, kam lënë legenin në korridori... kur thera pulat. (Me zë të lartë.)
Hajdeni, ju bëftë mamaja!

Hyn Valmira. Vajza futet për herë të parë në shtëpinë e Niqiforit. Gratë e presin pak të hutuara...

SHKËLQIMI — Mamaja!... Halla ime!... Valmira
është një shoqja ime, shoqe pune e babait...
Ka ardhur të urojë për babanë... Po, baba
nuk qenka këtu?

ERIFILI — Jo... Doli... U mërzit dhe doli!

VALMIRA — Unë e lashë në uzinë!

SHKËLQIMI — Ec e merru vesh me të!

LENA — Na falni të shpiem pak pjatat.

Gratë dalin.

VALMIRA — Si më rreh zemra!... E zeza unë,
ç'm'u desh që erdha!

SHKËLQIMI — Mos u bëj si fëmijë tani e, Mirka!

VALMIRA — Po sikur ai të më rrrijë ftohtë?

SHKËLQIMI — Jo de... Unë e bisedova me manë dhe mamaja do t'i ketë thënë atij.

VALMIRA — Të kishe bisseduar vetë.

SHKËLQIMI — Më vinte zor.

VALMIRA — Bëra gabim që erdha... Duket si-kur rashë e vdiqa të bëhem nuse e tij.

SHKËLQIMI — Ti sot ke ardhur për urim... Si-kur t'i shkrepej të të thoshte ndonjë gjë për punën tonë do të ishte ideale...

VALMIRA — Më mirë jo... Nuk duroj dot... Pastaj ai duhet të më kërkojë nuse për ty, ashtu si të kam porositur. Të kujtohet? Nuk ia the mamasë se si...

SHKËLQIMI — Jo... Këto janë teka!

VALMIRA — Nuk janë teka! Ti ma ke fajin. (Brof në këmbë.) Çimi, unë më mirë po iki dhe të shpëtoj...

SHKËLQIMI — (E ul me zor.) Ulu!
Kthehen të dyja gratë.

ERIFILI — Ç'ka Valmira?

SHKËLQIMI — Pyet... Ka merak. Kur do të vijë babai, thotë.

VALMIRA — Vërtet, do të vonohet?

ERIFILI — Nuk besoj... Me leje të zakonshme e kemi...

VALMIRA — E di, e di.

ERIFILI — Kishte pesë vjet pa e marrë... Shyqyr që e mori. Po ç'e do... Ja, prapë në punë!

SHKËLQIMI — S'ka gjë, mama... I bën mirë për ristabilizimin e qendrave nervore... Eliminon eksitimet e tepërtë... Kohët e fundit me shëndet ka qenë më mirë. (Valmires.) Lëre këto ditë: ka një qetësi organi-

ke... Pa nerva fare... pa të bërtitura. (Vë
veshin.) Erdhi!

Dëgjohet një rrapëllimë.

ZËRI I NIQIFORIT — Pthutu... Ju hëngërt dreqi,
me gjithë legen! Desh theva kokën. Pesë-
dhjetë vjeç plot... Të humburat e dreqit.
(Futet në dhomë duke çaluar.)

NIQIFORI — (Valmirës) pa e vënë re mirë. Ti,
hiqe atë legen! (Mbetet i befasuar.)

ERIFILI — Ka ardhur të të uroj ditëlindjen!

NIQIFORI — (Ende i hutuar.) Kush ta tha? Këtë
e dinë vetëm katër veta!

ERIFILI — Po Çekoja, që telefonoi nga Tirana?

NIQIFORI — Pesë!

LENA — Po Leksi nga Ferma?

NIQIFORI — Ja gjashtë... Bashkimi shtatë...

VALMIRA — (Shikon Shkëlqimin.) Unë...

NIQIFORI — Vërtet, nuk është zor. Ja, mirë se
na erdhe, do të të mbajmë për darkë. (Gra-
ve). U njohët?... Kjo është Valmira. Na bën
remontin. Ing. rep-rem! (Valmirës) Ky është
diali im, Shkëlqimi!

VALMIRA — (Tund kokën.) Gëzohem!

NIQIFORI — Gëzohu... (Duke u zhveshur). Gëzohu
dhe ti, motëri!... Ma ka bërë shumë qejfin
Leksi.

LENA — Vërtet??

NIQIFORI — Më mori në telefon... Dajo, më tha,
nëntëdhjetë e nëntë për qind sonte nuk vi.
Kemi punë. Mua zemra mal.

LENA — Mal?... Mal meqë s'vjen??

NIQIFORI — Kuptoje drejt, de! Lë festën e dajos
për punën... Moj, po ti duhet të bësh festë për

vete... Tani më pëlqen që e kam nip... Hajdutin e kumbullave!...

LENA — (*Gati në të qarë.*) Ti tallesh... Ai në fshat... Jo po do të llafosemi mirë... (*Sulet në kuzhinë.*) M'u dogjënë embëlsirat.

NIQIFORI — Jo po nuk ndreqet kollaj Lena... Tjetri thotë ndreqet... Po nuk ndreqet kaq shpejt. E do djalin prapë në qytet... (*Hyn në dhomën tjetër.*)

VALMIRA — E pe?

SHKËLQIMI — E pasë.

VALMIRA — Jashtëzakonisht ftohtë! Me legen më priti.

SHKËLQIMI — Legeni kishte ujë të ftohtë.
Zilja e derës.

NIQIFORI — Urdhéroni! (*Del të hapë portën. Dalin të gjithë vec Valmirës. Dëgjohen përshëndetje dhe pas pak dhoma mbushet përsëri. Për urim ka ardhur Bashkimi dhe dy nga punëtorët e remontit, Guroja e Rexhepi.*)

BASHKIMI — Dhe Çeçoja nuk rri pa ardhur!... Këtë shërbimin e sotëm nuk e deshte.

NIQIFORI — E di, e di... Me zor u nis!

ERIFILI — Fori, shiko sa telegrame për ty!

NIQIFORI — (*Duke kaluar nëpër duar telegramet.*) E di... Ti ke ditëlindjen dhe nuk do të bësh zhurmë... Kujton se të tjerët kanë punë... Punë dhe të harrojnë... Nuk të harrojnë!... Shokë të largët... O, o... pa shiko... E dini kush e dërgon këtë?... Hë, Valmira... S'e dini sigurisht! (*Lexon*). «Ju uroj ditëlindjen, duke ju kujtar ju dhe uzinën ku punova deri në ditën e qarkullimit...»

Me respekt të plotë Rushka.»

BASHKIMI — Tip i çuditshëm!

NIQIFORI — Mjaltë dhe zamkë... Përzierë!

LENA — (*Hyn me vrap në dhomë.*) Zetori! Zetori...

Nuk dëgjoni nga veshët? Zetori!... Ka ardhur Leksi me zetorin e preshëve.

Që jashtë dëgjohet përshëndetja e borisë së zetorit.

LENA — (*Duke bërtitur në paradhomë.*) Leksi, t'u bëftë Lena!... Leksi!

Dëgjohen të bërtiturat e saj të gëzueshme nëpër shkallët e pallatit «Leksi», «Leksi». Pas pak shfaqet Leksi gazmor, — me rrobat gjithë baltë.)

LEKSI — (*Në dhomë.*) Mirëmbrëma!... (Qëndron përpara Niqiforit.) Shoku... (Të qeshura). Dajë, shoku Fori! (Prapë të qeshura). Shoku drejtor, dajë Fori!... M'u ngul mua kjo, ec e ta shkul tani pér nja dy vjet... Megjithatë të uroj nga zemra të bëhesh njëqind e pesëdhjetë vjeç. Me sy e veshë e këmbë e duar. E në punë! Se ashtu do ti. (*Nxjerr një pako të madhe.*) Gjeje se ç'të kam sjellë si dhuratë nga fshati!

NIQIFORI — Kumbulla!

LEKSI — Jo! Gjeje!

NIQIFORI — Leri gjëzat e hape ta shohim!

LEKSI — Të kam sjellë një dhuratë që s'ta ka sjellë asnjeri... Duket kështu pér të qeshur, por prit, prit se do të të pëlqejë! (*Hap pakon dhe nxjerr nën zhurmën e të qeshurave, një domate të stërmadhe të serave dhe një spec topolak.*) — Këto janë nga ato më të voglat, se të tjerat na i morën pér ekspozitë. Janë

nga prodhimet e brigadës ku Aleksi, nipi yt,
është një nga më të dalluarit...

LENA — Po sot s'të mori televizori, më raftë pika
mua!

LEKSI — Shikoje pasnesër: (*Niqiforit.*) Tani, a të
pëlqen dhurata?

NIQIFORI — (*I prekur.*) Shumë!... Dhurata më e
bukur... Eja të të puth? (*Përqafohen.*)

SHEFQETI — (*Që ka hyrë befas.*) Mendova se do
t'ju gjeja duke pirë, po ju qenkeni akoma
gjatë ceremonisë... (*Puhet me Niqiforin.*)
Urime!

ERIFILI — Ulu, Çeço, se do të jesh lodhur!

SHEFQETI — Nuk ulem fare pa jua thënë një
lajm të gjëzuar nga Tirana... (*Me zë të
ulët, gazmor e konfidencial.*) Se mos na dalë
llafi, se s'ka marrë formë të prerë, po edhe
këtë vit uzina jonë është propozuar për
flamur!

ZERA — Urime, Niqifor! Urime, shokë! Urime,
inxhiniere! Urime, Çeço!

ERIFILI — Merrni gotat për urim... Bashkë bëjeni
urimin!

SHEFQETI — Ta pjekim, Niqifor... Gëzuar të pesë-
dhjetat! Jetë të gjatë e me mësimet e Partisë
dhe të shokut Enver gjithmonë pranë. Dhe
për lajmin e gjëzuar që solla, urime!

NIQIFORI — Faleminderit, Çeço... Urime dhe ty.
Mbushja prapë Çecos!

SHEFQETI — Vërtet, de, se urimet janë dy.

NIQIFORI — Më duket se do të bëhen tre... Ma
ndjell zemra.

Pauzë. Vëmendja dalngadalë kthehet te Valmira.

NIQIFORI — Valmira, moj vajzë. Të dua nuse për djalin. Të lutem prano, se ti je tamam nusja që i duhet djalit tim!...

Pauzë e nderë.

VALMIRA — (Shkëlqimit.) Po ti ia paske mësuar!

SHKËLQIMI — (I habitur.) Jo... Unë nuk ia kam thënë. Çudi!

NIQIFORI — Ty, zoti doktor, të pëlqyen fjalët e kërkesës?

SHKËLQIMI — Kush t'i tha?

NIQIFORI — Kam edhe unë dedektivët e mi. (Valmirës.) Hë, moj çupë, c'thua?

VALMIRA — Unë... Nuk di. Kjo po më vjen shumë papritur... Unë erdha për urim.

NIQIFORI — E di. Tani unë do të të kërkoj edhe te babai...

SHEFQETI — Edhe te mamaja!

NIQIFORI — Edhe te mamaja! Po ti, c'thua?

VALMIRA — Unë... të mendohem.

NIQIFORI — Mendohu.

SHKËLQIMI — Se ç'kam një parandjenjë që do të thotë po.

VALMIRA — Dhe unë... më duket se do të them po.

NIQIFORI — Dalë të të puth në ballë.

Valmira i afrohet Niqiforit, e puth.

SHEFQETI — Ti, Fori, ke filluar t'i bësh punët çorap...

NIQIFORI — Pse?

SHEFQETI — Po i heq uzinës një inxhiniere të mirë... Le që ti nuk e ke dashur kurrë.

Nga na kumbisi këtu, ke thënë!

NIQIFORI — Lere ç'kam thënë... Ta heqim? Je në vete?! S'gjen njeri që t'i rrijë remontit mbi kokë, siç i rri kjo.

SHEFQETI — Gjen, s'gjen... ajo duhet hequr. Dy kuadro nga një familje, rrezik të hyjnë në familjaritet.

NIQIFORI — Familjaritet unë me këtë? Bah! Ju e njihni... Të fal kjo?!

SHEFQETI — Megjithatë duhet transferuar.

NIQIFORI — Po tani fillojmë disa remonte kapitale... Si inxhiniere nuk e le.

SHEFQETI — Atëherë do ta leshë si nuse... Se në fakt kurrë nuk e ke dashur... «Mjerë kuit t'i zerë derën», ke thënë.

NIQIFORI — Po lere ç'kam thënë! As si nuse nuk e le!

SHEFQETI — Zgjidh: e do inxhiniere në uzinë apo nuse në shtëpi?

NIQIFORI — (Duke u menduar.) Ta bëjmë kështu: i fejojmë, po të mos e shballim fejesën.

SHKËLQIMI — Sa kohë. baba?

NIQIFORI — Shohim e bëjmë, po njëherë për njëherë sa të mbarojnë këto remonte kapitale. nuk bëjmë zë... Prandaj... (Me gisht në hundë.) Shshsht!... Leksi, shshsht!

LEKSI — Andei nga ferma e kam merak vetë unë.

NIQIFORI — Ti, Lena, leri llafet me gratë.

LENA — Ohu... hapet llafi.

NIQIFORI — Pse të hapet? Ja, këtu tanët jemi. Shsht! Ti, Valmira vetë shshsht. C'thua?

VALMIRA — Unë them se nuk ka asnjë rrezik... ne do të jemi kudo bashkë... dhe në punë

dhe në shtëpi: kritikë reciproke dhe dashuri.
(*Zgjatet në majë të këmbëve dhe e puth.*)

NIQIFORI — Megjithatë, hëpërhc që të jem i sigruar... unë... Shshsht!... (*Spektatorëve.*)
Edhe ju eh... Patë, ç'patë sonte këtu...
Shsht... (*Mysafirëve.*) Hë, ore, mos më lini
vetëm.

TË GJITHË — (*Porositin spektatorët me gisht në hundë.*) Shshshsht!

F u n d .